


E Kështjës



Drita e Kur'anit



FLETUSHKË E SHOQATËS SË NXËNËSVE TË MEDRESESË SË MESME "ALAUDDIN" NË PRISHTINË



Fjala e redaktorit

Me ndihmën e Allahut xh.sh. edhe ky numër i fletushkës "Drita e Kur'anit" e pa dritën, duke shprehur se kjo dritë do të ndriqojë çdo zemër që kërkon udhëxim. Jemi përfjeksur që edhe këtë numër ta begatojmë me tema të ndryshme e të larmishme duke filluar nga ato islame, kulturore e shkencore. Njëpërmyet këtyre shkrimeve jemi përfjeksur të shpjegojmë rëndësinë e Islamit dhe rolin e metodologjisë së thirrjes në besim të drejtë kah toleranca, solidariteti dhe uniteti në islam. Fletushka "Drita e Kur'anit" si një pishtare e vertetë, synon të jetë prijëse dhe fanar yni drejt shtigjeve të lumturisë. Në si mbrojtës besnikë të Islamit burimor duhet që emanolin që e kemi marrë mbi supe ta ruajmë dhe ta xhatojmë me besnikërinë dhe konsekuencën më të madhe. Duhet t'u tregojmë të gjithëve se xhihadi besimi burimor nuk është sinonim i dhunës dhe terrorit, por është një përfjekje fisnike për t'i mbrojtur të drejtat elementare njerëzore, për ta mbrojtur fjalën e shkruar, dijen, arsimin, shkollën, atdheun, lirinë etj. E lusim të Plotëfuqishmin që zemrat tona t'i mbushë me dritë dhe iman të paluhatshtëm, që kjo dritë e Kur'anit të gajë errësirën para syve ende të mjegulluar e të fluturojë drejt shtigjeve të ardhmërisë, duke fushuar zemrat e njerëzve e sidomos të rinisë e cila në këto kohëra të liga e të veshitura, sikur po kërkon ankoren e shpëtimin në limanin e shpësës. Flavdishëm është Loti xh.sh. që në Kur'an tha: "Ata (pabesimtarët) duan ta shuajnë dritën e Allahut me gojën e tyre por Allahu e plotëson (përfjeks) dritën e tij edhe pse këtë e urrejnë pabesimtarët. Ai (Allahu) është që e dërgoi të dërguarin e Vet me udhëxim të gartë e fe të vertetë, për ta bërë mbixotëruese mbi të gjitha fetë edhe pse këtë pabesimtarët e urrejnë. (Es-Saf 8-9) Allahu na ndihmoftë!!!

Adnan Simnica

Botues:

Shogata e nxënëseve të Medresesë së Mesme

"Alauddin" Prishtinë

Kryeredaktor: Adnan Simnica

Këshilli redaktues:

Bajrush Ahmeti, Rrustem Spalau, Jusuf Gashi, Ahmet

Rama, Emin Dërguti, Jakup Çunaku, Adem Breznica,

Florim Gruda, Adnan Sogojeva, Afrim Isufi dhe Agron

Tërzigi

Lektor dhe korrektor: Jusuf Gashi

Përpunim kompjuterik: 

Fletushka del sipas mundësisë

Adresa: Redaksia e "Nurit" f.p. 89, Prishtinë

Tel. 038/32-472 & 32-473

Është lejuar botimi i fletushkës "NUR-UL-KUR'AN" me vendimin e Sekretariatit për informata të Kuvendit të Kosovës dhe Këshillit Ekzekutiv nr. 01-650-64 të dt. 18.3.1973 në Prishtinë

Dorëshkrimet nuk kthehen

Përmbajtja

Vizita e shtëpisë së shërytë Qabes - Haxhi	4
Kurbani - afrim pranë Mëshurës hyjnore	6
Hixhreti	8
E duam lirinë	9
Islami është dituri dhe kulturë	10
Islami	11
E vërteta për origjinën dhe zhvillimin e sistemit diellor	12
Pse ndryshojnë muajt dhe vitet?!	15
A edini se	17
Vlerën që ia dha njeriut Allahu xh.sh.	18
Anketë	19
Mbulesa islame - hixhabi	20
Në shtëpi kemi një problem	22
Këshillimi	23
Kujdesi dhe vëmendja për fëmijërinë	24
Kush është në të vërtetë i verbër	25
Detyra e nxënësit ndaj mësuesit	27
Lëvizjet shkatërruese në historinë islame	28
Vlera e punës	29
Lantumirë Medrese	30

Lexues të nderuar!

- Patëm fatin që në këtë vit shkollor "Drita e Kur'anit" të prezantohet në dy numra. Dhe këtë në kohët kur besimtarët e besimit islam janë më të devotshëm dhe më afër Allahut xh.sh.

Numri i parë iu kushtua Ramazanit, muaj ku besimtarët mobilizohen me devotshmëri dhe solidaritet në mes veti.

Ky numër del me rastin e Kurban Bajramit, gjegjësisht të kohës e Haxhit. Kurban simbolizon sakrificën e individëve për bashkësinë njerëzore. Shembulli i Ibrahimit a.s. i cili dëshiroi të sakrifikojë të birin për të arritur kënaqësinë e Allahut xh.sh. në të mirë të bashkësisë njerëzore. Derisa Ismaili a.s. nuk e kundërshtoi të atin sepse ishte i bindur se vepra e babait të tij kishte arsyen e vet që i shërben idealit të lartë njerëzor. Allahu xh.sh. e mëshiroi Ibrahimin a.s. me të birin Ismailin a.s., e që simbolizon mëshirën e pakufishme të Allahut ndaj genies njerëzore.

Me Kurban, gjegjësisht derdhja e gjakut të tij simbolizon sakrificën e pasurisë së besimtarit në emër të Allahut xh.sh., ndërsa mishi i Kurbanit i cili u ndahet të varfërve dhe të afërmeve është solidariteti i besimtarëve me gjininë njerëzore dhe vërtetim se njeriu është qenie e përsosur, i udhëzuar nga Allahu nëpërmjet të dërguarëve të tij.

Haxhi simbolizon simbolin e shtëpisë së parë e cila iu kushtua Allahut xh.sh. Lugina e Mekës shkretëtirë pa ujë, pa tokë pjellore etj u zgjodh si qendër e rruzullit tokësor kah e cila drejtohen fytyrat e muslimanëve në momentin kur janë më së afërmi Allahut xh.sh. (namazi).

A thua Ibrahimit a.s. rastësisht e la një pjesë të familjes së tij në këtë shkretëtirë duke iu lutur Zotit me fjalë:

"Dhe kur Ibrahimit a.s. tha: O zoti im, bëre këtë një qytet sigurie dhe banorët e tij që besuan Allahun dhe jetën tjetër, furnizoi me lloje të frutave! Ai (Allahu) tha: (e furnizoi) edhe atij që nuk besoi do t'i mundësojë shfrytëzimin e frutave për një kohë të shkurtër, e pastaj do të shtijë në dënimin e zjarrit. E sa përfundim i hidhur është ai". (El-Bekare 126).

Mund të themi se jo, sepse ai ishte i udhëzuar nga i Lartëmadhëruari që me lënien e një pjese të familjes në luginën e Mekës, të themelohet një qytet si qendër shpirtërore, kulturore e tregtare.

Me tubimin e besimtarëve në haxh arrihet qëllimi që ia kishte dedikuar Allahu xh.sh. Mekës së shenjtë, e kjo është ngritja shpirtërore e besimtarëve si dhe lartësimi e madhërimi i Allahut. Njëherit shprehet edhe falënderimi i njerëzve ndaj Allahut për dashurinë e tij që shpreh ndaj njerëzimit.

Në kohën e haxhit në rrugët e Mekës jehojnë thirrjet e besimtarëve të cilat mbulojnë hapësirën e Mekës, e simbolikisht edhe të rruzullit tokësor me fjalët: **LE-BEJK ALLAHUME LE-BEJK**, ku besimtari i përgjigjet thirrjes së Allahut që t'i nënshtrohet Atij dhe të jetë njeri me plot kuptimin e fjalës.

Redaksia

Vizita e shtëpisë së shenjtë Qabës - Haxhi

Thotë Allahu xh.sh. në suren Ali Imran:

"Shtëpia e parë e ndërtuar për njerëz është ajo që u ngrit në Bekë (Mekë), e bekuar dhe udhërrëfyese për mbarë njerëzimin".

Kur'ani na tregon për udhëtimin e Ibrahimit a.s., me bashkëshorten Haxheren dhe të birin Ismailin a.s. në një luginë të paplleshme ku gjendet sot Meka. Ky udhëtim nuk ishte i rastit dhe krye në vete, edhe pse Kur'ani këtë çështje nuk e sqaron në detaje. A thua nuk kishte ndonjë vend tjetër që do të ishte më i përshtatshëm dhe më i volitshëm për banim. Gjithësesi, kishte, por qëllimi i këtij udhëtimi dhe vendosja e një pjese të familjes së tij në atë vend, pa ujë e pa gjallëri, do të krijojë kushte për zbulimin e një të vërtete të vendosur qysh nga Ademi a.s., por që ishte mbuluar nga vërshima në kohën e Nuhit a.s.


Për këtë arsye All-llahu xh.sh. dëshiroi që të zbulohet e vërteta e mëhershme, ndaj, kur do Ai që të zbulojë

një të vërtetë të madhe e të kahershme, krijon kushtet, arsyet dhe mundësitë drejt saj. Për ta vërtetuar këtë në Kur'an janë të cekura fjalët e Ibrahimit a.s.:

"O Zoti ynë, unë vendosa një pjesë nga pasardhësit e mi në luginën e paplleshme të shtëpiajote të shenjtë. Zoti ynë të bëhen të tillë që të luten, pra bëre që zemrat e disa njerëzve të anojnë, të tërhiqen kah ata, i furnizo ata me lloj lloj frytësh, ato do të bëhen mirënjohës dhe falënderues" (Ibrahim 27)

Kjo jep të kuptohet se Qabja ka ekzistuar edhe më parë, ndërsa Ibrahim a.s. me të birin Ismailin e ngritën mbi themelet e vjetra për ç'arsye e lusin Allahun xh.sh. që t'ua pranojë punën dhe mundin. Ata thanë: *O Zoti ynë, pranoje prej nesh (këtë vepër) se me të vërtetë ti je që dëgjon dhe i di të gjitha" (El-Bekare 127).*

Ndoshta të mirat që i gëzoi populli i këtij vendi janë rezultat i lutjes së Ibrahimit, të cilën ia pranoi Zoti xh.sh.. Pas ngritjes së themeleve të saj Allahu e urdhëroi t'i thërrasë



njerëzit për të vizituar atë shtëpi të ndershme ku edhe i thotë: "thirr ndër njerëz për haxh". (Haxh 27). Dhe kështu vjen në vend urdhëri i Zotit, ai vend i thatë e i shkretë, bëhet synim dhe shpëtim i njerëzisë dhe bëhet kujtim i përjetshëm i ngjarjeve të Ibrahimit a.s. për tërë kohën sa të ekzistojë. Allahu xh.sh. e madhëroi atë shtëpi dhe shenjtëria e saj do të vazhdojë sa të jetë jeta nejrëzore, e bëri vend afrimi ndaj Tij. E gjithë kjo u cek edhe në sheriatin e pejgamberit të fundit a.s. i cili është vula e të gjithë pejgamberëve, dhe mu për këtë na del në shesh pse Ibrahimit me të birin e tij e mësyen këtë vend. D.m.th. Ibrahimit a.s. e ka ditur se aty është vend i shenjtë, ku është e cekur edhe në ajet "te shtëpia jote e shenjtë". - Qabja, shtëpia e parë për adhurim të një Zoti.

Thotë Allahu xh.sh.:

"Shtëpia (xhamia) e parë e ndërtuar për njerëz, është ajo që u ngrit në Bekë (Mekë), e bekuar dhe udhërrëfyese për mbarë njerëzimin. Në të ka shenja të qarta: vendi (mekami) i Ibrahimit dhe kush hyn në të, ai është i sigurt. Të vizituarit e tempullit (Qabës) për hirë të Allahut, është obligim për atë që ka mundësi ta marrë këtë udhë, e kush nuk e beson (mohon këtë urdhër të Allahut), Allahu me të vërtetë nuk ka nevojë për askend". (ali Imran 96,97).

E para shtëpi që është ndërtuar për ta adhuruar Zotin xh.sh. është Qabja, të cilën e bekoj Zoti dhe nga gjiri i këtij vendi i dhuroi njerëzisë margaritarin më të çmuar, Muhammedin a.s. duke e zgjedhur udhërrëfyese dhe dritë për ata të cilët besojnë.

Qabja u bë pikësynim për besimtarët, duke e mësyre atë me plot shpresë dhe admirim vetëm e vetëm për t'iu përgjigjur me respekt thirrjes së All-llahut xh.sh. Me qenë se haxhi bëhet vetëm një herë në jetë, për atë që ka mundësi dhe në një kohë të caktuar, haxhilerët kanë për detyrë t'i përmbahen disiplinës dhe rregullave të islamit.

Jemi të porositur nga Muhammedi a.s. që kur të shohim Qabën të themi: "O zot, shtoja kësaj shtëpie autoritetin, madhërinë, nderin dhe begatinë".

Në oborrin e saj të bekuar ka shenja të qarta të cilat vërtetojnë madhërinë e saj. Aty gjendet mekamu Ibrahim, vend ku shihen gjurmët e tij, si dhe në të djathtë të tij gjendet edhe mekamu Ismail. Në oborrin e saj gjendet edhe burimi i Zemzemit, i cili shekuj me radhë shuan etjen e haxhilerëve dhe të vendasve. Më tutje gjenden dy

kodrat, Safa dhe Merva, për të cilat në Kur'an thuhet: "Safa dhe Merve janë nga shenjat e Allahut, e kush e mësyn shtëpinë (Qabën) për haxh ose për umre nuk është mëkat për të, t'i vizitojë ato dya..." (Bekare 158), në mes të të cilave haxhilerët ecin me vrap për të kujtuar Haxheren, e cila vrapoi shtatë herë në mes tyre për të gjetur ujë, për shuarjen e etjes së Ismailit a.s..

Përsa i përket hedhjes së gurëve, ky është përkujtim i fitores së Ibrahimit a.s. me Ismailin kundër shejtanit, i cili u përpoq ta prindin nga zbatimi i urdhërit të Zotit për therrjen e të birit dhe të bindë të birin që të mos e respektojë propozimin e prindit. Prandaj, edhe haxhiu gjatë këtij vrapimi duhet ta prezentojë atë fitore dhe të kërkojë prej Zotit xh.sh. ndihmë, që shejtani të mos mundet ta luhatë rrugën e tij të drejtë.

Për madhërimin e saj besimtarët bëjnë tavaf, i cili ka mbetur që nga koha e Ibrahimit, i cili pasi ngriti Qabën u soll rreth saj shtatë herë duke e lutur Allahun që t'ia pranojë këtë vepër dhe pasardhësve të tij t'ua pranojë (lutjet).

Me kthimin e fytyrave të besimtarëve kah ajo gjatë namazit shihet respekti, madhërimi dhe nderimi ndaj saj.

Haxh pra do të thotë mësyria Qabës për ta vizituar në një kohë të caktuar, për dallim nga umreja e cila mund të kryhet në çdo kohë gjatë vitit. Njëherit haxhi është edhe prej shtyllave të Islamit dhe është bërë obligim në vitin e nëntë sipas hixhretit, me ajetin 97 të sures Ali Imran.

Është kënaqësi dhe lumturi e madhe përjetimi i Haxhit. Në të marrin pjesë me miliona njerëz nga të gjitha anët e botës dhe të të gjitha racave, ku me plot të drejtë mban epitetin e kongresit gjithislam-botërorë. E gjithë kjo barazi vërehet edhe me anë të veshjes së ihramit për të gjithë pa dallime, sepse atëherë muslimanët i dallon vetëm devotshmëria e jo pozita apo pasuria. Duke kaluar para Qabës të duket se para syve të dalin fytyrat më të ndritshme të historisë islame, të duket se sheh të Dërguarin me ashabët duke u lutur për lartësimin e *Islamit*. Andaj është mëkat i madh për ndonjë musliman i cili ka mundësi udhëtimi, të mos e shfrytëzojë pjesëmarrjen në këtë *kongres të madh*. Prandaj ti përgjigjemi thirrjes së singertë të Zotit xh.sh. me respekt, dashuri dhe nxitim, **LEBBEJKE ALLAHUMME LEBBEJKE**, "I përgjigjem thirrjes sate o Zot".

Adnan Simnica IVA

KURBANI - AFRIM PRANË MËSHIRËS HYJNORE

Kanë mbetur vetëm edhe ca ditë që ta përjetojmë atmosferën e festës së Haxhit dhe të Kurban Bajramit, festë e cila sjell paqë, gëzim dhe haramoni në shtëpitë e të gjithë muslimanëve. Është kjo një festë ku ndjenja kolektive mbizotëron mbi atë individuale. Muslimani duke e pasur zemren plot besim me ndërgjegje të pastër e të lartë dhe me një qëndrim merititor ndaj Krijuesit të tij, i kthehet ymnetit duke qenë i vetëdijshëm se vetëm kjo rrugë (islame) vërteton integritetin e tij të sënder-tuar si individ.

Është festë ku shumë vëllezër tanë marrin rrugën për vizitë vendeve të shenjta. Vizitojnë Meken, vendin ku Ibrahim a.s. ngriti themelet e shtëpisë së shenjtë - Qabes, që të adhurohet vetëm Allahu xh.sh.. Allahu e bekoi atë (shtëpi) duke e emërtuar si shtëpi të shenjtë dhe duke e bërë qendër kah e cila duhet të kthehemi kur ta falim namazin.

Gjatë kryerjes së kësaj vizite të shenjtë arrihet një atmosferë me plot devotshmëri, duke i vizituar Safan, Merven, Arafatin etj., të cilat dëshmojnë famën islame dhe lënë gjurmë të pashlyer në shpirtrat tonë të cilin e ruajmë deri në frymën e fundit.

Në këto vende, muslimanët e të gjitha viseve takohen, bisedojnë, lidhin miqësi, kur të bashkuar afrohen në të njëjten ditë dhe në të njëjtin vend për të lutur Allahun me të vetmen dua për paqë, lumturi e fatbardhësi gjithnjëzore.

Këtë festë e ngrit në një pedestal edhe më të lartë prerja e kurbanit, i cili si institucion zë vend të spikatur në historinë dhe legjislaturen islame.

Sakrifica, flijimi dhe prerja e kurbanit është institucion i vjetër në faqet e historisë njerëzore. Kjo formë flijimi daton qysh nga bijtë e Ademit a.s. - Kabili dhe Habili për zgjedhjen e një mosmarrveshje ndërmjet tyre.

Allahu xh.sh. në Kur'an thotë:

"Lexoju (O Muhamed) atyre (jehudive e të tjerëve) ngjarjen e vërtetë të dy djemve të Ademit, kur të dy flijuan kurbanë, nga të clët njerit iu pranua ndërsa tjetrit nuk iu pranua. ai (që nuk iu pranua) tha: Unë do të të mbys ty. E ai (të cilit iu pranua) tha: Allahu pranon vetëm prej të sinqertëve". (El-Maide 27)

Pastaj ngjarjen kulminante të Ibrahimit a.s. i cili nga devotshmëria dhe respekti i thellë ndaj Krijuesit të gjithësisë që në gjendje që të flijojë frytin e zemrës së tij të birit Ismailin a.s.. Allahu xh.sh. thotë:

"Dhe kur arriti ai (djali-Ismaili) që së bashku me të (me Ibrahimin) të angazhohet në punë, ai (Ibrahimi) tha: O djali im, unë kam parë (jam urdhëruar) ëndërr të pres ty. shiko pra ç'mendon ti tha: O babai im, punoje atë që të është urdhëruar, sepse ti, nëse do Allahu do të më gësh mua në mesin e besimtarëve. Dhe kur ata dy iu dorëzuan uredhërit të Zotit dhe përmbysi atë në fytyrë (ballë), Ne e thirrëm atë: O Ibrahim, ti tashmë e zbatove ëndërrën (premtimin e dhënë)! Ne kështu i shpërblejmë të mirët, vërtet kjo është një sprovë e qartë. Ne shpaguam atë me një Kurban të madh". (Es-Safat 102-107)

Nga këto ajete të sipërtheksuara më lart mund të konkludojmë se qëllimi final i zbatimit të këtij obligimi është mëshira dhe afrimi tek Allahu xh.sh.. Duke filluar nga ky parim edhe peygamberi ynë Muhamedi a.s. vazhdoi këtë traditë dhe urdhëroi të kryhet që në vitin e dytë hixhrij.

Në atë vit Muhamedi a.s. pas faljes së namazit të bajramit u kthye në shtëpi dhe preu dy kurba. Njërin e therri për vetveten dhe familjen e tij duke thënë: "O Zot, kjo është nga unë për ty", kurse tjetrin për ymetin e tij duke thënë: "O Zot, është nga ymeti im, për secilin



që vërteton se Ti je i Vetëm dhe se unë e kam përcjellë emanetin Tënd".

Ky institucion i flijimit ishte i njohur edhe nga popujtë e mëhershëm, por duhet të dimë se përderisa në besimet tjera flijimi ishte institucion për të fituar simpatitë dhe bekimet e idhujve dhe "hyjnive" të imagjinuara, në islam flijimi është institucion gatishmërie për të flijuar gjënë më të shtrenjtë dhe më të dashur që e posedojmë vetëm në emër të Allahut xh.sh. Allahu xh.sh. i drejtohet Muhamedit a.s. dhe ymetit të tij duke thënë:

"Thuaj, namazi im, kurbanim, jeta ime dhe vdekja ime janë vetëm për Allahun, Zotin e të gjitha botrave". (El-Enam 162).

Fjala Kurban, nëse analizohet në esencë, nuk ka qëllim tjetër vetëm se afrim te Allahu xh.sh.

Njëherit është fakt i pamohueshëm se Allahu xh.sh. nuk ka nevojë për askë dhe asgjë, por ne kemi nevojë për mëshirën e tij. Allahu xh.sh. nuk i mungohet e as nuk i shtohet asgjë në Madhërinë e Tij, premë apo nuk premë Kurban. Tek ai arrin vetëm devotshmëria jonë ngase i Lartëmadhërishmi thotë:

"Tek Allahu nuk arrin as mishi, e as gjaku i tyre (kurbanëve), por tek Ai arrin takvallëku i juaj". (El-Haxh 37).

Për therrjen e Kurbanit kemi baza të forta si në Kur'an ashtu edhe në Hadith. Allahu xh.sh. në Kur'an thotë: "... edhe therr Kurban..." (El-Kevther 2).

Komentuesit e Kur'anit janë në ujdi se ky ajet na obligon të gjithë ata muslimanë të cilët kanë mundësi të therrin Kurban. Për zbatimin e kësaj detyre të shenjtë gjejmë mbështetje edhe në Hadith:

"Kush ka mundësi të therrë Kurban e nuk therr, mos 'ti afrohet vendit të faljes së namazit tonë".

Duke u bazuar në fjalët hyjnore të Allahut xh.sh. dhe të dërguarit të Tij imam Ebu Hanifja këtë institucion e radhit në shkallën e vaxhibit.

Qëllimi i zbatimit të këtij institucioni është që gëzimin të cilin e përjetojnë të pasurit le ta përjetojnë edhe të varfërit, të cilët nga modestia dhe ngurrimi nuk e shprehin varfërinë e tyre. Të ndajmë kurbanin ashtu siç e ndajmë gëzimin apo lumturinë, sepse për këtë e kemi imperativin kur'anor.

"...hani prej tij (kurbanit) dhe ushqeni të gjerët dhe të varfërit". Në këtë ajet shprehet qëllimi themelor ku nëpërmjet kësaj detyre të shenjtë do të zhdukej egoizmi dhe zilia, kujdesi ndaj vetvetës do të kalonte edhe në të tjerët, të cilët kanë nevojë.

Nga e tërë kjo që thamë vetvetiu lind pyetja:

Vallë, a ka njeri që mund të flijojë gjënë më të shtrenjtë, përveç atij të cilit drita e imanit i ka dëpërtuar thell në zemër, përveç atij të cilit zemra dhe gjuha janë udhëzuar me fjalët e Allahut xh.sh. dhe të Muhamedit a.s.?

Duke e zbatuar këtë vepër madhështore për hir të Allahut xh.sh. arrihet vetëdija më e lartë e besimit dhe gatishmëria për realizimin e qëllimeve të shenjta fetare.

Na ndihmo o Krijues i gjithësisë që t'i kryejmë këto obligime siç ke urdhëruar dhe ashtu siç ka vepruar Muhammedi a.s.

Atyre të cilëve kanë marrë këtë rrugë për vizitë shtepinë e shenjtë, ua bënë haxhin mebrur (të pranuar) ndërsa ata të cilët therrin kurban vetëm për hir Tëndin shpërblej me shpërblimet Tua të pakufishme.

Paqa dhe mëshira e Allahut goftë mbi të gjithë muslimanët!!!

Përgatiti: Jakup Çunaku IVb.

HIXHRETI

Një ndër ngjarjet më rëndësi në historinë e Fesë islame është edhe Hixhreti i Pejgamberit a.s.

Është një fakt i njohur se idetë e reja, qofshin shoqërore ose politike, gjithmonë luftohen në fillim, sidomos kur vijnë në kundërshtim me interesat personale a të ndonjë grupi.

Kjo gjë i ndodhi edhe Muhammedit kur filloi ta predikojë fenë e All-llahut xh.sh. Ai dhe shokët e tij u torturuan në mënyrë barbare. Pas një periudhe, më se dhjetë vite vuajtje dhe mundime, disa banorë nga Medina, që në atë kohë quhej Jethrib, pranuan Islamin.

Pejgamberi duke parë se vuajtjet dhe persekutimet çdo ditë shtoheshin dhe jeta bëhej e padurueshme, i urdhëroi shokët e tij që të shpërngulen në Jethrib ku do të gëzonin lirinë e besimit.

Kështu grupe të muslimanëve filluan të shpërngulen nga Meka në Jethrib. Kjo gjë i brengosi mushrikët kurejsh, nga arsyeja se muslimanët, pasi të shkonin në Jethrib, do të formonin shtetin e tyre dhe do të gëzonin lirinë e besimit në All-llahu xh.sh., dhe një ditë do të forcohen dhe do t'i sulmojnë mushrikët kruejsh. Mirëpo nga ana tjetër ata panë se Pejgamberi ende gjendej në Meke. Pas shumë debatesh ata mbështeten njëzëri vendimin për t'i qeruar hesapet me Pejgamberin a.s. sa ai ishte në Meke, dhe kështu të shpetonin nga frika që u kishte hyrë. Kështu me një mbledhje të mbajtur në Daru Nedve u bënë shumë propozime. Propozimin e parë e bëri Ebu Eswedi i cili shfaqti mendimin që ta largojnë Muhammedin a.s. nga vendi i tyre dhe mandej ai të shkojë dhe kështu ta hiqnin qafe. Mirëpo plaku i Nexhdit (shejtani në formë njeriu) që merrte pjesë në atë mbledhje, e kundërshtoi këtë propozim duke thënë: "Ju e dini se sa fjalëmbël është ai, se sa kuvend të bukur që mban, se si i sundon zemrat dhe i bën për vete të gjithë prandaj unë frikësohem se në qoftë se ne e largojmë, ai mund të mbeshtetet në fiset e tjera arabe të cilat do t'i besojnë dhe do t'i binden. Më vonë ai mund të na sulmojë me ato fise dhe të bëjë çka të dojë me ne. Prandaj gjeni tjetër zgjedhje".

Pati edhe propozime të tjera mirëpo nuk i pranuan asnjë me përjashtim të propozimit të Ebu Xhehlit i cili

duke përdorur dinakërinë e tij, propozoi: Të merrët nga një djalë i ri nga shtatë fiset, djem të fuqishëm të pajisën me nga një shpatë dhe ata ta sulmojnë së bashku dhe ta mbysin. Kështu të shpetojmë sepse gjaku i tij do të shëprndahet në fiset mekase, dhe kështu fisi i Muhamedit a.s. nuk do të ketë mundësi të luftojë kundër shtatë fiseve për t'u hakmarrë.

Pas këtij propozimi përsëri u ngrit në këmbë plaku i Nexhdit dhe tha: Këto fjalë janë të vërteta dhe ky propozim është i vlefshëm, ta miratojmë!

Në këtë mënyrë kuvendi i zullumçarëve kurejsh vendosi që ta vriste Pejgamberin a.s. që ta fikte këtë dritë të çmueshme. Mirëpo a do të lejonte Zoti xh.sh. që të fikej ajo dritë përpara se të plotësohej dhe përhapej e të ndriçojë të gjitha këndet e kësaj gjithësie?

Jo kurrësesi. Për këtë Zoti xh.sh. thotë: "Dëshirojnë që ta shuajnë dritën e Zotit xh.sh. me frymën e tyre, por me kot se Zoti xh.sh. do ta plotësojë atë dritë derisa të ndriçojë dhe të triumfojë mbi çdo fe të kaluar edhe nëse pabesimtarët nuk e dëshirojnë një gjë të tillë".

Pas këtij vendimi të shëmtuar të mushrikëve kurejsh menjëherë zbriti Xhibrili a.s. me një shpallje nga ana e Zotit xh.sh. dhe njoftoi pejgamberin a.s. për vendimin kriminal që kishin marrë armiqtë kundër tij dhe me këtë rast Zoti xh.sh. e lejonte të emigronte nga Meka.

Xhibrili a.s. e urdhëronte mos të flente në shtratin e tij të zakonshëm. Muhammedi menjëherë pas shpalljes nga ana e Zotit xh.sh. shkoi te Ebu Bekri dhe i tregoi se i kishte ardhur leja (urdhëri) për të bërë hixhretin. Ebu Bekri iu lut Pejgamberit a.s. që ta pranonte për shok rruge, Pejgamberi a.s. e pranoi. Kaq shumë u gëzua Ebu Bekri sa që Ajsheja r.a. ka thënë: "Nuk kam parë ndonjë burrë që qanë nga gëzimi para babait tim me rastin kur e pranoi Muhammedi a.s. për shok rruge.

Pejgamberi a.s. e Ebu Bekri filluan që ta hartojnë planin e largimit nga Meka, e ai plan ishte:

Muhammedi do të urdhëro Aliun r.a. që të flejë në shtratin e tij dhe të mbulohet me mbulesën e tij, mandej Muhammedi a.s. do të dalë nga shtëpia e vet i vetëm,

për t'u takuar me Ebu Bekrin i cili do ta priste i përgatitur me dy deve me ushqimet e duhura.

Prej këtu do të merrnin rrugën për Medine. Muhammedi u nis për në shtëpinë e vet dhe priste orën e caktuar.

Në orën e caktuar Pejgamberi doli nga shtëpia e vet duke marrë një grusht dhe nga toka dhe ua gjuajti çdo njerit prej shtatë djelmoshave nga pak dhe mbi kokë dhe në të njëjtën kohë citonte ajetet e sures Jasin deri te ajeti i nëntë ku All-llahu xh.sh. thotë:

"Ne kemi vënë edhe para tyre pendë edhe mbrapa tyre pendë dhe ua kemi mbuluar sytë, prandaj ata nuk shohin". (Suretu Jasin - 9)

Kështu pra Muhammedi a.s., pa e parë ata fare u largua, ndërsa djelmoshat pritnin aty deri sa erdhi një njeri i cili nuk kishte qenë me ata dhe u tha: Ç'jeni duke pritur këtu? Ata i thanë, Muhammedin. Njeriu tha: "Pasha Zotin Muhammedi veç sa doli prej këtu dhe nuk la asnjë prej jush pa u gjuajtur dhe mbi kokë dhe u largua".

Pejgamberi tani filloi një rrugë të re plot mund dhe sakrificë, vetëm e vetëm që fjala e All-llahut të ngritet lart. Pejgamberi a.s. shpëtoi nga shtatë djelmoshat dhe All-llahu xh.sh. ua asgjësoi planet e tyre. Këtë All-llahu na dokumenton në Kur'an ku thotë: "Përkujto (O Muhammed) kur ata që nuk besuan thurnin kundër teje të ngujojnë, të mbysin ose të dëbojnë, ata bënë plane e All-llahu është më i mirë, që i asgjëson dredhitë e tyre". (El-Enfal -30).

pejgamberi tri ditë qëndroi në shpellë me Ebu Bekrin. Kështu një ditë mushrikët i ishin afruar shpelles dhe Ebu Bekri filloi të frikësohej dhe ia filloi të qajë, mirëpo Pejgabmeri a.s. e qetësoi duke i thënë: "Mos u frikëso se All-llahu është me ne".

Natën e katërt u përgatiten ta lëshojnë shpellën e të nisen për Medine. Dhe kështu pas dhjetë dymbëdhjetë ditësh arritën në Medine dhe pikërisht ditën e hënë me dymbëdhjetë, Rebiul Evel, ditën e lindjes ku po në këtë ditë dhe në këtë datë, pas disa viteve do të ndërrojë jetë.

Sa madhështore ishte hyrja e Muhammedit në Medine, sepse me ardhjen e tij në Medine do të formohet shteti Islam me legjislaturë Islame dhe moral nga ana e All-llahut xh.sh.. Do të ngritet një shtet të cilin nuk e njih historia, dhe nuk do ta njih kurrë.

Hixhreti në fillim ishte një ngjarje e hidhur sepse muslimanet lanë familjen, pasurinë, vendlindjen, vetëm e vetëm që një ditë të triumfojnë, dhe kjo ndodhi pas tetë vitesh kur hynë ngadhënjimtarë në Mekë, pasi që ishin larguar me dhunë.

Hixhreti ka edhe rëndësinë tjetër, sepse pas tij filloi epoka e re për muslimanët. Hixhreti la rrënjë të thella jo vetëm në historinë Islame por edhe në historinë botërore, sepse më vonë do të formohet shteti i cili do t'i shkatërrojë edhe dy perandoritë më të mëdha të asaj kohe, Perandorinë Persiane dhe atë Bizantine.

Ja pra ky është hixhreti i pejgamberit, i cili u shpërngul vetëm që fjala e All-llahut të ngritet lart, e jo për qëllime tjera siç mundohen t'ia mveshin orientalistët evropianë, kinse është shpërngulur për qëllime ekonomike-sociale apo për shfryrjen e epsheve të kësaj bote. Mirëpo Muhammedi a.s. dhe feja Islame janë të pastërt nga çdo thënie e pabesimtarëve sepse kanë pasur mbështetje në All-llahun xh.sh.

Përgatiti: Ahmet Hoxha k. IVb

E duam lirinë

*O diell i bukur, sa rreze të ngrohta lëshon
dhe ti o j pranverë e dashur, ngadalë po lulëzon
E nëna shqiptare qan e mendon,
për të birin e saj që në varr po e çon
Në kohën më të bukur, në moshën rinore
varri i një të riu, është mbuluar me kurorë.*

*Në vend se në Kosovë të vijë aromë zambaku,
në Kosovën tonë, vjen aromë gjaku.
Hapi krahët tua dhe fluturo në qiell,
që të gjithë shqiptarët të shohin pakëz diell.*

*Një manaferrë e dobët diellin po ta zë,
të rritesh të zhvillohesh, të lulëzosh ajo nuk të lë.*

*Dhatë jetën për liri, që të jetojmë të lirë,
por Zoti do t'ju shpërblejë me një gjë të mirë.
Lindemi, rritemi, vdesim, kështu ne jetojmë,
por nga Zoti i madhëruar ndihmë duhet të kërkojmë.*

*Lusin Zotin, gjithmonë natë e ditë,
që të na mbulojë neve, me paqë, mëshirë, liri dhe dritë.*

Muharrem Tërava II

ISLAMI ËSHTË DITURI E KULTURË

Derisa fjala e parë e shpalljes islame është LEXO kuptohet se ideologjia e besimit islami është dituri, e kjo kuptohet edhe më mirë kur e dimë se Kur'ani i shenjtë përbëhet prej më se 6666 versete, 750 sish janë që thërrasin njeriun në përgatitje për dituri, për ta njohur gjithësinë, hapsirën, trupat qiellorë, natyrën, elementet biologjike, medicinale etj. Sipas parimeve islame Zoti krijoi gjithçka për të mirën e njeriut, dhe pasiqë njeriu e bëri zëvendës të vetin në tokë e urdhëroi t'i shfrytëzojë të gjitha begatitë. I dha të kuptojë se qielli, toka, natyra e gjithçka tjetër janë miqtë e tij, d.m.th. i dha të kuptojë se njeriu jeton në mesin e miqve të vet, e nëse ndonjëherë lajmërohet ndonjë prej tyre si armik, atëherë atë armiçësi duhet kërkuar në lëshimet e njeriut. Mirëpo, për t'i shfrytëzuar begatitë lypset aftësia në dituri, prandaj edhe kërkoi shpallja islame nga njerëzit që të aftësohen në pikëpamje të diturisë, e diturinë e quajti dritë, dhe dijetarin të gjallë, kurse paditurinë errësirë e të paditurin të vdekur. Të nxitur prej këtyre parimeve, besimtarët e parë të besimit islam iu përmbajtën koshient vleftes së diturisë dhe për gjysmë shekulli arritën t'i përhapin mesimet islame më tepër se që e përhapen romakët imperatorinë e tyre për shtatë shekuj me radhë.

Islami është kulturë e përparim, sepse, kultura buron prej diturisë e dituria prej një besimi të fortë dhe të sinqertë. Pra islami lindi dhe u zhvillua në atë vend dhe nder atë popull shkretinas, i cili nuk kishte kurrfarë ligji të caktuar nga ndonjë mbretëri e imperatori. Ai duke qenë krejt i lirë nga ndikimet e huaja dhe duke u mbështetur vetëm në parimet e veta, themeloi rregullin e jetës praktike duke i përfshirë të gjitha elementet e domosdoshme për jetë dhe ashtu formoi shoqëri e shtet të pastërt. Kultura islame e cila pati për burim diturinë, por diturinë besnike e të sinqertë, kulturën, islame

mund ta kuptojmë edhe më mirë nëse i bëjmë një vështrim të kaluarës historike kur ra imperatoria romake (476 miladi). Evropa hyn në atë periudhë e cila historikisht quhet - koha e mesme - dhe vazhdoi deri në fund të shekullit XV. Gjatë këtyre 10 shekujve dhe disa decenieve në Evropë ishte natë e errët, natë e frikësuar të ciles me shekuj iu vonua drita - agimi. Në atë kohë e tërë situata ishte në duar të fuqishëmve, sunduesve mbretërve, falltorëve të cilët jetën e kuptonin grabitje, plaqkitez. Lufta për sundim e shtoi edhe më tepër paditurinë, injorancën dhe errësirën, sepse, edhe ato pak drita të diturisë së trashëguar nga romakët dhe grekët, u fiken. Gjendja kishte arritur deri në atë shkallë sa që sunduesit e Evropës mburrëshin me paditurinë e tyre (analfabetizmin). Në atë kohë lufta me shpata konsiderohej si autoritet më i lartë, kurse dituria dhe arsimi konsiderohej si punë të ligshita dhe mjeshtëri e përtacëve. Nga kjo që theksuam më lart mund të kuptojmë se Evropa ishte plot prapambeturi, injorancë, xhahiljet i pakufishëm. Në shekullin e VI gjegjësisht në vitin 622 miladi të erës sonë në Gadishullin Arabik lajmërohet islami dritë dhe udhërefyes për shëptimin e njerëzisë nga ajo humnerë, injorancë në të cilën kishte rënë Evropa. Menjëherë pas fillimit të shpalljes myslimanët të cilët besuan pa kurrfarë dyshimi në fjalën - Zoti është një dhe përpos tij nuk ka, dhe se Pejgamberi është i dërguar dhe rob i Tij, dhe iu përveshen dijes e cila nuk ka fund, iu përveshën Kuranit, filluan ta ndjekin rrugën e të dërguarit Muhammedit a.s. Nga këto dituri të bazuara në parimet silame kjo dritë e diturisë u përhap me një shpejtësi sikurse plumbi, arriti në perëndim deri në Spanjë, e në Lindje deri në Kinë duke e pajisur njerëzinë me dituri e ndjenja të pasterta shpirtërore. Kjo dritë islame nuk ishte larg nga Evropa e cila e urrente

diturinë dhe bënte shkatërrim në tokën e vet dhe e shtyer nga injoranca u përpoq ta shuajë atë dritë duke u vërsulur në luftëra sikurse egersira, por me kot, me atë nuk arriti asgjë, Islami zgjerohej dhe bëhej edhe më i fort. Pas shumë kohe dhe pas një analize e studimi të gjatë, Evropa e kuptoi fshehtësinë e asaj fuqie të pathyer të arabëve shkretinas, e kuptoi se ajo ishte dituria e vërtetë, prandaj edhe u detyruan të drejtohen nga shkollat islame, dyert e të cilës ishin të hapura për të gjithë ata që kërkonin dije, pa marrë parasysh ngjyrën, racën, kombin etj.. Për një kohë të gjatë Evropa dërgoi nxënës në shkollat islame, natyrisht në ato shkolla që i kishte më afër, si në: Kordovë, Granadë, Ishbili etj.

Paraqitja me shkrim e kërkesës së mbretit të Anglisë drejtuar sunduesit emevi në Spanjë është dokumenti më i mirë historik i cili na paraqet më së miri, dhe më se kjarti gjendjen e atëhershme të Evropës e që është:

"Nga Xhorxhi i dytë - mbreti i Anglisë, Suedisë dhe Norvegjisë dërguar" halifit Hishamit të III. Pas shumë nderimeve dhe respekti. "kemi dëgjuar për nivelin e lartë dhe suksesin e madh që është arritur në institucionet tuaja shkencore dhe për ndërtimin e qyteteve tuaja të bukura. Dëshirojmë të përfitojmë nga ato të arritura të larta, nga ajo dritë e diturisë dhe nga ai ndertim i bukur diçka edhe për qytetet tona, të cilat i ka përfshirë injoranca e padituria nga të katër anët, prandaj kemi përgatitur një grup vajza - bija të njerëzve më të lartë në krye me bijën e mbretëreshes Dobant-en për t'i ndjekur mësimet në shkollat tuaja. Nga shërbëtori i juaj - i respektuari Gjergji}. Pra një paraqitje e këtitillë sunduesit më të madh të Evropës në atë kohë, e përshkruan gjendjen e vërtetë që mbretëronte në atë kohë në tërë Evropën dhe kërkon pranimin e nxënësve të Evropës në shkollat islame, kjo na jep të kuptojmë kjartë mbi prapambeturinë e Evropës dhe mbi përsosshmërinë e shkollave islame, ku përveç meshkujve edhe femrat mësonin të gjitha degët e shkencës e veçanërisht në atë të medicinës.

Qëndrimin tolerant të shtetit islam e vërteton edhe filozofi amerikan Draperi ku thotë:

Myslimanët e parë në kohën e halifëve nuk i kufizuan marrëdhëniet e tyre me krishterë e hebrenj vetëm në respektimin e diturisë, por atyre ua besuan edhe pozita të larta në shtet, duke mos shiquar nga i cili vend ishin ata dhe se çfarë feje kishin lindur e rritur.

Nga kjo që u tha deri më tani mund të kuptojmë se myslimanët qenë flamurtarë në çdo lëmi, derisa iu përmbajtën parimeve të shëndosha të ideologjisë së tyre, e kur u larguan nga ato atëherë u bënë shërbëtorë të botës. Të kuptohemi, islami është ai me të gjitha cilësitë e bukura humane, përparimtare e kulturore, por vlen vetëm zbatimimi në praktikë. Të gjitha të metat që i përjetoi islami janë të meta të njerëzve e jo të islamit.

Musli Zymeri IIIb

Islami

*O ju njerëz që jetoni
dhe ju që punoni
a e dini se çka duhet të besoni
Ejani të shiqojmë se si duhet të besojmë
të besojmë si është më së drejti
këtë e tregon realiteti.*

*Feja islame na mëson shumë të vërteta
të cilat s'mund t'i mësojmë qoftë edhe sa të
jetë jeta*

*Nuk është fe e trilluar, e as e gabuar
por fe e vërtetë dhe shumë e qëlluar.*

*Feja islame nuk është vetëm e një populli
por e mbarë njerëzimit e shpallur prej Zotit.
E vlefshme ishte kur u shpall
e vlefshme është edhe sot
dhe e vlefshme do të jetë për jetë e mot.*

Driton Morina II

E VËRTETA PËR ORIGJINËN DHE ZHVILLIMIN E SISTEMIT DIELLOR

"Thuaj: Udhëtoni nëpër botë që të shihni çka ka krijuar Ai prej asgjës...". (Suretu El Ankebut - 20)

Deri më sot janë paraqitur më 100 teori të formimit të sistemit diellor, por rezultatet e arritura nuk inkurajojnë..

Situata në këtë drejtim është mjaft e ndërlikuar, sepse hipotezat pa të dhëna të mjaftueshme fizike dhe pa shpjegimin e vrojtimeve të diktuarat sot nuk pranohen fare.

Çdo teori e formimit të sistemit diellor duhet të përgjigjet në këto pyetje: Pse të gjithë planetët sillen rreth Diellit dhe ky rreth boshtit të vet, rrotullohen në të njëjtën kahje?

Pse, shumica e planetëve rrotullohen rreth boshtit të vet në kahje të lëvizjes rreth Diellit?

Pse, sasia e lëvizjes së Diellit rreth boshtit është afro 2%, kurse sasia e lëvizjes këndore e të gjithë palentëve është afro 98%, kurse e dimë se Dielli e ka masën afro 1000 herë më të madhe se të gjithë planetët së bashku.

Këso pyetjesh ka mjaft dhe mu në tentimin e përgjigjeve të tyre kanë rënë shumë teori deri më sot.

Si hipotezë e parë kosmogonike mund të merret hipoteza e Byfonit e paraqitur me një kometë të madhe.

Nga materia e hudhur gjatë kësaj ndeshje Byfoni e sheh formimin e planetëve.

Hipotezë tjetër për formimin e sistemit diellor është edhe hipoteza e Kantit e paraqitur më 1755. Kanti fillimin e sistemit diellor e mendon nga masa e nxehtë dhe e rrallë, e cila nga veprimi gravitacional është ngjeshur dhe ka filluar të rrotullohet shpejtë e më shpejtë. Nga ky rrotullim ai mendon se janë ndarë unazat e veçuarat të materies prej të cilave më vonë u formuan planetet.

Trajtimin matematik të teorisë së Kantit e bëri Laplasi, më 1796, i cili të përbashkët me atë të Kantit ka paramjegullën e gazet, por të atillë që veç gjendej në gjendje rrotullimit të ngadalshëm. Duke u ftohur sfera e gazet tkurret dhe e zmadhon shpejtësinë këndore. Nga ky rrotullim ajo kalon në disk me ekuator më tepër të zgjeruar nga i cili brez një nga një ndahen unazat e materies. Këto unaza kondenzohen në planetë.

Kjo formë gjatë disa milionë vjetësh u përsërit nëntë herë, prandaj sistemi diellor i ka nëntë planete.

Teoria e Byfonit që në fillim u vërtetua se është e pabazë, sepse Toka disa herë ka kaluar nëpër bisht të kometës dhe nuk është vërejtur kurrfarë turbullire në të, kurse ndeshja e Diellit me kometë është e pakuptim, për formimin e planetëve.

Teoria e Kantit-Laplasit është menduar më tepër se një shekull e pazëvendësuar dhe gjeniale. Tek më vonë u vërejt se kjo teori ka të meta rrënjesore.

Sipas mekanizmit të paraqitur, Diellit duhet t'i ketë mbetur pjesa më e madhe e impulsit këndor. Vetëm për hudhjen e unazës për formimin e Neptunit, impulsi total këndor do të duhej të ishte afro 200 herë më i madh se i sotit. Pastaj, kondenzimi i unazës së gazet në sferë është shumë më pak i besuar se sa zbërthimi i saj.

Kjo teori nuk arriti t'i shpjegojë vrojtimit astronomike, prandaj disa astronomë më vonë thirrën në ndihmë ndodhitë katastrofale të Gjithësisë. Në këtë drejtim, hipotezën e katastrofës e përtrijnë: Si (1901). Çemberlen dhe Milton (1910) dhe Xhin Xhinsi, më 1919.

Sipas Xhin Xhinsit, para disa miliardë vitesh pranë Diellit ka kaluar një ylli gjigant. Nga tërheqja gravitacionale një pjesë e materies së nxehtë ka marrë formë tampusi (cigareje), prej së cilës më vonë u formuan sferat, të cilat me kalimin e kohës u ftohën. Në këtë mënyrë u formuan planetet e sistemit Diellor.

Kjo teori që në hapin e parë mund të merret si e pabazë, sepse të besuarit e afrimit të ndonjë ylli pranë Diellit është sikurse 1:10 miliardë, kurse për stabilitetin e orbitave nevojitet edhe prania e trupit të tretë.

Për të njohur realisht problemin e krijimit të sistemit diellor dhe për ta interpretuar ashtu siç është, duhet të mbështetemi në mrekullitë e Kur'anit a.sh. të cilat janë të panumërta në lëmenj të ndryshëm e veçanërisht në lëmin e fizikës dhe astrofizikës.

Në Kur'anin a.s. thuhet:

"Ne u sqaruam njerëzve në këtë Kur'an shembuj (argumente) të çdo lloji..." (Suretu el Israë -89)

Të shohim në vazhdimin se cilat argumente kur'anore na shërbejnë në rastin tonë. Kështu, shqyrtimin e problemit duhet ta fillojmë nga ajeti kur'anor:

"Pastaj vendosi (ta rregullojë) qiellin, ndërsa ai (ishte) në gjendje të gazet..." (Suretu Fussilet -11)

Ajeti i cekur më sipër na tregon se prej gjendjes së gazet (mjegullt) u krijua gjithësia dhe yjet me planetet. Kështu ekzistojnë shumë teori bashkëkohore për formimin e planeteve.

Mjafton të cekem këto: teoria e Shmitit, e Vajskerit, e Kuperit, e Kameronit, e Hajlit etj. Teoria e Shmitit bazohet në hipotezën e kapjes. Këtë teori Shmiti e dha në vitin 1951. sipas tij, Dielli gjatë rrugës së vet në Galaktikë, kalon nëpër material nderyllor, e tërheq atë dhe e detyron që të tkurret, të formohen paraplanetët dhe të levizin rreth tij. Në këtë rast rolin e trupit të tretë e luan Galaktika.

Shumica e teorive bashkëkohore kanë mjaft hipoteza të përbashkëta, por pak a shumë gjatë shtjellimit të problemit marrin formë të veçuar. Kështu si teori e argumentuar në botën shkencore mund të merret vetëm ajo që për krijimin e sistemit diellor merr mjegullën e gazet e cila ceket në ajetin e mësipërm.

"Vallë, a nuk shohin ata të cilët nuk besojnë se qiejtë dhe Toka kanë qenë një tërësi, dhe ne i ndamë ato..." (Suretu El Enbija -30)

Përmbajtjen e ajetit të mësipërm në prizmen e shkencës bashkëkohore mund ta vërejmë kështu:

Në Gjithësi ka mjaft mjegullira nderyllore, të cilat në disa vende janë më të dendura, kurse në vende të tjera më të rralluara. Vendet më të dendura fillojnë të luajnë rolin e bërthamës duke tërhequr vazhdimisht grimcat e materies dhe pluhurit nderyllor që gjendet në afërsi. Në këtë mënyrë formohet sfera e madhe, e cila në fillim është e ftohtë, por shumë më e madhe se ylli që do të formohet më vonë nga ajo.

Mendohet se sfera nga e cila është formuar Dielli (paradielli) ka pasur diametër disa qindra herë më të madh se Dielli i sotëm. Sfera e ftohtë dhe e rrallë fillon të ngjeshet, ndërsa nga fërkimi dhe presioni brendësia e saj fillon të nxehet ngadalë. Kur temperatura në brendë arrin në disa milionë gradë, fillojnë reaksionet termobërthamore të shndërrimit të hidrogjenit në helium dhe lind ylli i ri.

Nga ajeti kur'anor:

"Allahu e fillon krijimin, mandej e përsërit atë..." (Suretu el Rrum - 11)

kuptojmë se në Gjithësi yjet krijohen edhe në ditët e sotshme.

Por, në Gjithësi të gjithë trupat në formim nuk kanë fat të shndërrohen në yje. Nëse në vende të caktuara nuk ka mundur të grumbullohet aq materie saçë nga ngjeshja të sigurohet temperatura e mjaftueshme në bërthamë për t'u zhvilluar reaksionet termobërthamore, ylli nuk do të lindë, por do të lindë planet. Pra, sipas teorive bashkëkohore, planetët nuk kanë lindur nga Dielli, por nga e njëjta materie e ftohët (ky fakt ceket edhe në Suretu Fussilet -11). Kështu lindin yjet sipas teorive bashkëkohore e së bashku me ta edhe planetët nga materiali i mbetur nderyllor. Dikur është menduar se yjet e dyfishta dhe të shumëfishta paraqesin dukuri mjaft të rrallë në Gjithësi. Më vonë me teleskop të fuqishëm u diktua se yjet e dyfishta paraqesin dukuri normale. Kështu, p.sh. Poluks dhe Kastor në njësinë e binjakëve janë yje të pesëfishta dhe të gjashtëfishta. Numri i yjeve të shumëfishta i diktuar në kohë të fundit vetëm që e plotëson saktësinë e teorive bashkëkohore të formimit të yjeve dhe të planetëve. Në të vërtetë, gjatë formimit të yjeve, pramjegullina gjigante nderyllore është zbrëthyer në grupe të vogla a të mëdha të mjegullinave të gazet dhe të pluhurit. Nga grumbujt e mëdhenj janë formuar yjet e formuara ose të shumëfishta, ndërsa nga grumbujt e vegjël janë formuar planetet. Kjo e dhënë pajtohet me faktin se edhe sot linden yje të shumëfishta. Lindja e tyre kryhet në ato pjesë të Gjithësisë, ku janë grumbulluar mjegullirat gjigante të pulhurit ose gazet.

Kështu, Jupiteri, planeti më i madh i sistemit Diellor, dikur ka qenë më i madhi dhe ka ngelur si planet, sepse nuk ka mundur që të grumbullojë sasi të madhe të materialit.

Temperatura në brendësi të tij nuk ka qenë e mjaftueshme për fillimin e reaksioneve termobërthamore.

Duke u bazuar në teoritë bashkëkohore të formimit të yjeve dhe të planeteve mund të përgjigjemi në pyetjen se pse, planetet që janë afër Diellit (Merkuri, Venera, Toka, Marsi) janë të vegjël dhe të ngjeshur, ndërsa planetët e larguara nga Dielli (Jupiteri, Saturni, Urani, Neptuni) janë të mëdhenj dhe të rrallë. Gjatë formimit të Diellit nga mjegulla gjigante e pluhurit dhe gazet një pjesë e materialit ka filluar të rrotullohet si mjegullinë e ftohët duke vazhduar të rrotullohet me kohë është shndërruar në disk. Në brendësi të këtij disku ka qëndruar grumbulli më i madh.

Nga ai grumbull më vonë është krijuar Dielli.

Nga veprimi dëbues i rrezatimit të tij në afërsi nuk ka mbetur sasi e madhe e gazet dhe e pluhurit. Nga goditjet

joelastike gjatë lëvizjes kaotike mjegulla paraplanetare ka filluar të kondenzohet në rrafshin e diskut duke formuar grumbuj stabil të madhësisë së asteroideve.

Në afërsi të Diellit kanë mundur të ngelin vetëm materiet e forta prej të cilave janë të përbëra Merkuri, Venera, Toka dhe Marsi, kurse materialet e lehta (Hidrogjeni dhe gazrat e ndryshëm) kanë mundur të kondenzohen vetëm në largësi të mëdha nga Dielli dhe atë në largësi të Jupiterit.

Në fazën e dytë të formimit të planeteve të sistemit diellor pason lëvizja e grumbullimeve paraplanetare.

Në këtë fazë nuk goditen vetëm grimcat e vogla, por goditen dhe bashkohen masat e mëdha të madhësisë së asteroidëve.

Me kohë në këtë mënyrë janë formuar nëntë planete të mëdhenj duke formuar tri grupe themelore, dhe atë planetët e tipit të Tokës, të tipit të Jupiterit dhe brezi i asteroidëve në kufirin e tyre. Asteroidët janë formuar në atë vend të hapësirës, ku nuk kanë ekzistuar kushtet për formimin e planeteve të tipit të Tokës dhe të Jupiterit.

Siç shihet, nga sa u cek më sipër, teoritë më bashkëkohore për lindjen dhe formimin e sistemit diellor bazohen në faktin e krijimit të planetëve dhe të Diellit nga një mjegullinë e gaztë, të cilën gjë e gjejmë të përshkruar në Kur'an qysh para 14 shekujsh. Na mbetet në vazhdim të shqyrtojmë problemin e zhvillimit të mëturjes së Diellit dhe sistemit diellor.

Për këtë qëllim do të sjellim këto ajete nga Kur'ani a.sh.:
"Kur Dielli të jetë mbështjellë (dhe errësohet)".
(suretu et tekvir -1).

Duke vështruar përmbajtjen e ajetit të mësipërm, është e logjikshme të parashtrohet pyetja:

Si do të jetë fati i Diellit?

Përgjigja në pyetjen e parashtruar do të jetë kjo:

Është e qartë se sasia e hidrogjenit në Diell megjithëatë është e kufizuar. Kjo do të thotë se do të vijë koha kur dielli do të harxhojë "lëndën djegëse".

Kështu sasia e hidrogjenit në të premtan edhe 5-6 miliardë vjet. Tani për tani reaksionet termobërthamore kryhen pikërisht në afërsi të qendrës së Diellit, ku temperatura është maksimale. Prandaj, mungesa e hidrogjenit së pari do të ndihet në qendër, ku do të shndërrohet tërësisht në helium.

Kësisoj, "ndezyja" do të kalojë në shtresë të jashtme, në të cilën ende do të ketë hidrogjen nga kjo do të ndërrojë edhe struktura e brendësisë së Diellit, sepse

në vend të modelit pikësor të burimit do të kemi model shtresor, në të cilin energjia lirohet nga një shtresë e hollë e ndarë nga bërthama e djegur. Me harxhim të vazhdueshëm të hidrogjenit kjo shtresë bartet prej qendrës kah pjesa e jashtme. Tregohet jo vetëm për Diellin, por edhe për yjet në përgjithësi se me formimin shtresor të burimit brenda Diellit, shkaktohet zmadhimi i vëllimit të tij, por njëkohësisht edhe i dritësisë.

Pas këtij zgjerimi Dielli prapë fillon të mblidhet dhe të zbehet derisa të mos ftohet. Këtë fakt mjaft bukur e gjejmë të parqitur në Kur'an, pikërisht në Suretu et tekvir -1.

Të shohim në vazhdim ajetet:

"Dhe kur detet të vlojnë si zjarr i flakruar" (Suretu et tekvir -6)

ose

"Dhe të bashkohet Dielli e Hëna". (Suretu el Kijame -9)

Komentimin e dy ajeteve të mësipërme mund ta bëjmë kështu:

Me formimin shtresor të burimit brenda Diellit, shkaktohet zmadhimi i vëllimit të tij, e në të njëjtën kohë edhe i ndriçimit. Disa qindra milionë vjetë më vonë se fillimi i formimit të burimit shtresor, diametri i Diellit do të zmadhohet deri te orbita e Venerës, ndërsa dritësia do t'i zmadhohet për 10 deri 20 herë, duke shkaktuar avullim të fuqishëm dhe vlim të oqeanëve.

Kur vëllimi i Diellit zmadhohet deri te orbita e Venerës, të dy planetët më të afërm të Diellit do të përfundojnë në Diell.

Kështu, duke u shkurtuar trajektorët e lëvizjes së planetëve tjerë, Toka do të kalojë në orbitë të Venerës. Duke qenë planeti më i afërm i diellit, Toka do të mbetet pa satelitin e vet natyror - Hënën, sepse edhe ajo do të përfundojë në Diell.

Duke qenë në vendin e Venerës, Toka do t'i ketë karakteristikat e saj, e në veçanti ajo do të rrotullohet në kahje të kundërt me kahjen e lëvizjes së tanishme. Pra, në atë kohë në Tokë, Dielli do të përendojë ku lind sot, dhe do të lindë ku përendon sot. Temperatura në sipërfaqe të Tokës do të jetë ajo çfarë është sot në sipërfaqe të Venerës.

Në fund na mbetet të lavdërojmë Allahun e gjithëfuqishëm, i cili në Kur'anin a.sh. thotë:

"Ai robit të vet i shpall argumente të qarta për t'ju nxjerrë juve prej errësirave në dritë...". (suretu el Hadidë -9).

Fatmir M. Shatri

PSE NDRYSHOJNË MUAJT DHE VITET?!

Ky rregull i cili vigjilon në këtë ekzistencë bëri që shumë njërez të angazhohen dhe të futen në një oqean të pafund të mendimeve.

Këta miljarda trupa qiellorë, sa e sa satelitë natyrorë, janë të mbajtur e të ruajtur me një precizitet dhe rregull të mrekullueshëm. Ndër trupat qiellor që bënë polemika qysh në kohët më të hershme padyshim është edhe Hëna. Në vazhdim do të shohim disa nga veçoritë e saja. Hëna është trupi qiellor më i afërt me Tokën, paraqet satelitë natyrorë të saj dhe është i vetmi trup jashtëtokësor në të cilin disa herë ka shkelur këmba e njeriut. Është e larguar nga Toka për 384.400 deri në 407.700 km. Pasi që gjendet shumë afër Tokës në krahasim me trupat e tjerë na duket i të njëjtes madhësi me Diellin. Por, jo që është me e vogël se Dielli, por është edhe më e vogël se Toka. Rëndimi në të është gjashtë herë më i vogël se në Tokë.

Lëvizja e dukshme e Hënës

Përveç lëvizjes që e bën rreth Diellit (me sferen qiellore), Hëna ka edhe lëvizjen vetjake të cilën shumë lehtë mund ta diktojmë. Nëse i përcjellim pozitat e saj ndaj ndonjë trupi të ndritshëm edhe gjatë një nate do të shohim se brenda një ore do të zhvendoset kah lindja për afërsisht sa diametri i vet. Një rrotullim të plotë Hëna e kryen për 27,32 ditë ashtu që pas kalimit të asaj kohe do të vijë në të njëjtën pozitë ndaj atij ylli. Ky muaj quhet muaj yllor (siderik). Ndërsa muaji tjetër hënor i cili quhet muaj SINODIK ka 29.5 ditë muaj sipas të cilit është marrë kalendari musliman.

All-llahu në librin e Tij fisnik shumë qartë cek fazat dhe muajt sipas një kalendari i cili do të bazohet në pozitat e reflektimit të ditës së Hënës në sferën tokësore. All-llahu në Kur'an thotë: "Vërtet numri i muajve të All-llahut është 12, ashtu është caktuar në librin e All-llahut prej ditës kur i krijoi qiejt dhe tokën. Shkakun për të cilin muaji sinodik është më i gjatë se

ai siderik qëndron në faktin se muaji sinodik caktohet sipas fazave të cilat vërehen nga Toka. Ndërsa muaji siderik vërehet nga toka ndaj yllit për dallim nga tjetri i cili bëhet ndaj Diellit.

Faza e Hënës

Paraqitja e fazave të Hënës në të vërejturit nga Toka bëhet për shkaqet që vërehen në fig. 1, ndërsa për këtë Allahu në Kur'an thotë: "Edhe Hënës ia kemi caktuar fazat deri të kthehet në trajtën e harkut". (Jasin 39).




Fig 1.

Dielli gjithnjë ndriçon gjysmën, por nga toka nuk shihet gjithnjë gjysma. Kjo bën që pjesa e ndriçuar të vërehet sipas pozitës së saj ndaj Tokës. Pozitat të cilat i vërejmë nga Toka janë të vizatuar jashtë rrethi. Kur Hëna të gjendet në mes Tokës dhe Diellit atëherë gjysmësfera e ndriçuar është në anën e kundert të Tokës andaj ne nuk e shohim Hënën fare shih fig. 1. P1.

Kur Hëna largohet në P2 atëherë do të vërejmë një skaj të rrezatimit. Kur Hëna vjen në P3 do ta vërejmë se 1/4 e Hënës të ndriçuar. Në pozicionin P4 deri te P5

do të shohim se Hëna veç u mbush. Duke u larguar në P6 dhe P7 tash vetëm shkon duke u zbrazur pjesa e parë në P1 dhe P2 shih fig. 1. Kështu vazhdon deri kur vjen ne pozitën fillestare.

Për të gjitha këto caktime Allahu na lajmëron në zbritjen e Tij të ndershme të fundit me këto fjalë: "As Dielli nuk mund ta arrijë Hënën, e as nata ta zë ditën, por çdo gjë noton nëpër një orbitër të caktuar. (Jasin 40).

Meqë muaji hënor është më i shkurtër se ai diellor, viti hënor është për 11 ditë më i shkurtër. Përgjatë 33 viteve diellore do të fitohet 1 vit më tepër. Pra gjatë 33 viteve secili muaj bie në të gjitha stinët e vitit.

Shpërndarja e dritës

Allahu xh.sh. në Kuran nuk la pa e përmendur edhe një fenomen i cili mbretëron pa nderpre në këtë sferë tokësore. Andaj kjo shprehje e të Gjithmëshirushmit është kuptuar vetëm atëherë kur njeriu arriti që përmes satelitëve artificialë ta shikojë. I madhërueshmi thotë: (thua) "Ti e fute natën në ditë dhe ti e fute ditën në natë". (Ali Imran 27). Kjo mbështjellje pra mund të kuptohet nga të shikuarit e sjelljes së Tokës rreth boshtit të vet dhe rënies së rrezeve të Diellit në gjysmësferën tokësore.

Atmosfera e Tokës është e mbushur me grimca të vogla të pluhurit. Drita që arrin nga trupat qiellor, gëgjësisht nga Dielli shpërndahen në molekulat e ajrit dhe të pluhurit atmosferik. Valët e gjata të dritës rënsen i kalojnë pa pengesë grimcat e pluhurit atmosferik dhe molekulat e ajrit, ndërsa ato të shkurtat (të kaltërtat) duke u goditur me to, ndërrojnë kahjen dhe nuk depërtojnë tërësisht në sipërfaqe të Tokës.

Kjo është arsyeja pse neve na duket qielli i kaltër. Siç na tregojnë edhe kosmonautët, qielli është relativisht i zi, ndërsa ngjyra e kaltër e tij kur vrojtohet nga Toka është rrjedhim i shpërndarjes së rrezeve të kaltra. Në mënyrë të njëjtë mund të shpjegohet pse disku i Diellit a i Hënës afër horizontit duket tërësisht i kuq (lindje a perëndim). Meqë nga kjo pozitë rrezet duhet të kalojnë rrugë më të gjatë nëpër atmosferë deri të vrojtuesi atëherë arrijnë ato të kuqet. Atëherë pluhuri atmosferik mbushet me rreze të kuqe ndërsa neve na duket qielli i kuq.

EKLIPSET E DIELLIT DHE TË HËNËS

Eklipsi i Hënës

Sikurse çdo trup i errët edhe Toka e ndriçuar nga Dielli hijën e vet e hedh në anën e kundërt të saj. Eklipsët (zënia) e Hënës ndodhin vetëm atëherë kur është e plotë, pra kur gjendet në opozitë me Diellin. Zakonisht Hëna kalon në veri ose në jug të hijës konike të Tokës prandaj eklipsi i saj paraqitet vetëm kur Hëna e plotë gjendet në afërsi të njëres nyje të rrugës së vet. Nëse Hëna hyn në hijën e Tokës paraqitet eklipsi i plotë,




fig. 2

i cili mund të zgjase rreth dy orç. Në të kundërtën nëse Hëna kalon vetëm në skajin e hijes atëherë zënia do të jetë vetëm e pjesërishtme. Gjatë asaj kohe kur Hëna të jetë e plotë dhe të bëhet zënia, ndriçimi nuk humbet tërësisht, por do të ndriçojë shumë më dobët. Ky ndriçim bëhet nga thyerja e rrezeve në atmosferën e Tokës. Sot zënia e Hënës më së shumti shërben për hulumtimin e shtresave të larta të atmosferës tokësore. Shih fig. 2

Eklipsi i Diellit

Eklipsët e Diellit ndodhin vetëm atëherë kur Hëna është e re. Natyrisht jo në çdo muaj. Në pjesë të ndryshme të sipërfaqes së tokës zënia e Diellit shihet ndryshe. Jo vetëm që shihet ndryshe por edhe nuk fillon në të njëjtën kohë. Hija konike e Hënës do të bjerë në një sipërfaqe të vogël të Tokës shih fig. 3.




Fig. 3

Eklipsi (zënia) e plotë mund të vërehet nga brezi i gjatë disa mijëra km dhe i gjërë 200 km, në pjesët tjera paraqitet vetëm pjesërisht ose fare pak vërehet.

Edhe disa karakteristika

Hëna e kthen gjithmonë vetëm njërën anë prandaj për përpilimin e hartës është nevojitur të fotografohet edhe pjesa e padukshme e saj. Fotografimi i parë është bërë në vitin 1995, me 7 tetor nga anija sovjetike Lunjik III.

Në fund po e cekim se Hëna ka edhe dy satelitë natyrorë (dy Hëna tjera). Këto u vërejtën për herë të

parë në vitin 1956. Këto janë prej pluhurit dhe me diametër jo të madh. Masa e tyre është shumë e vogël dhe lëvizin në orbit të Hënës njëra me diametër 60 përpara, ndërsa tjetra 60 pas.

Dhe më në fund po e cekim fjalën e Allahut kur u drejtohet njerëzimit duke u thënë: "Në krijimin e të Gjithmëshirshmit nuk ka ndonjë kontrast mandej drejto shikimin tënd a sheh ndonjë çarje (ndeshje) pastaj herë pas here drejto shikimin (tënd) ndërsa ai do të kthehet i përulur e i molisur". (El-Mulk 3).

Behar Avdiu IV - b

A E DINI SE

1. Sa jetojnë xhinët?

Në Kuran është kjo fjalë e Allahut të madhëruar:

Ata (xhinët) thanë: "O populli ynë, ne dëgjuam një libër të shpallur pas Musaut (Kuranin), që vërteton atë para tij. Ai udhëzon në të vërtetën dhe në rrugë të drejtë" - Nga ky ajet kuranor vëhet në dukje se ata xhinë që e dëgjuan Kuranin jetuan që nga koha e Musaut a.s. dhe mbetën gjallë gjersa erdhi Muhamedi a.s. dhe zbriti Kurani famëlartë d.m.th. afro 3000 vjet.

2. Në Argjentinë jeton një lloj kali i cili konsiderohet se është më i vogël në botë. Është pak më i madh se një pulë e zakonshme, por, peshon më pak se 36 kg.

3. Synetija e fëmijëve meshkuj është pranuar si e detyruar në disa shtete të zhvilluara të botës bashkëkohore. Kështu që në SHBA 85% të fëmijëve të posalindur synetohen nëpër klinika për kohë të shkurtër pas lindjes.

4. Radioja më e vogël në botë është prodhimi i firmes Japoneze "Eoshiba". Ajo ka lloj valësh FM dhe AM. Është prodhuar në vitin 1983 dhe peshon 85 gr.

5. Njeriu më i gjatë në botë është pakistanezi Muhamed Alan Tunc, i cili është i gjatë 2.51 cm. Për Muhamedin duhet shtëpi me dhoma të posaçme. Për nusen e tij nuk ka shënime sa është e gjatë.

6. Në vitin 1798, Sulltani turk Selimi III e ka hedhur shigjetën në largësi prej 889 metra.

7. Emri më i përhapur në botë është emri Muhamed, e pas tij vjen emri Ivan.

8. Në vitin 891 Bagdadi numëronte mbi 100 biblioteka

9. Arabët mbanin vendin e parë në medicinë më shumë se 500 vjet, prej vitit 700 deri më 1200.

10. Muslimanët ishin të parët në botë që i themeluan observatoriumet.

11. Ujësjellësi i parë është ndërtuar në Sarajevë në vitin 1461 nga Gazi Isa Beu. Kurse në gjysmën e dytë të shek. XVI, ujësjellës kanë pasur edhe disa qytete të tjera të Bosnës. Në qytetet tjera të Evropës ujësjellësi është ndërtuar më vonë si: në Londër më 1609, në Vjen më 1839, në Moskë më 1878, në Paris më 1682...

12. Që të vishet një njëri nevojiten 93 km pe edhe atë: 15 km për ndërresa, 3.5 km për çorapa, 16 km për këmbishë, 1.5 km për kollarë si dhe 57 km për kat të teshave.

13. Njeriu i rritur kur është i shtrirë thith 3 litra ajer në minut, ulur 16 litra, duke ecur 24, ndërsa kur luan futboll 60 litra.

14. Disa ekspertë amerikanë kanë llogaritur se bleta duhet të fluturojë 68.000 km për të mbledhur gjysmë kilogrami mjaltë.

15. Vullkani më i madh gjendet në ishullin japonez Kinshju dhe quhet Aso. Krateri i tij është i gjatë 22 km, i gjërë 14 km dhe i thellë 500 m.

16. 800 vjet më parë arabët përdornin busulle prej hekuri magnetik në bishtin e peshkut. Ata e futnin në ujë dhe "peshku" kthente koken nga veriu. Këtë lloj busulle në Evropë e sollën italianët.

Irfan Krasmiq III/b

Vlerën që ia dha njeriut Allahu xh.sh.

Dëshiroi Zoti xh.sh. dhe krijoi gjithçka në këtë tokë e në qiej. Krijoi krijesa të shumta, krijoi shtatë palë qiej, e bëri tokën për gjallërim, vuri rendin dhe precizitetin që ekziston në natyrë.

Nga vetë fakti mund të themi se Zoti dëshiroi që se pari të përgatitë terrenin për një krijesë e cila do të ketë respekt të Zotit më shumë se çdo krijesë tjetër. Do të jetë krijesa më e dashur tek Allahu, do t'i mahnitë të gjitha krijesat tjera. Pra krijesa që Zoti xh.sh. do ta nderojë dhe veçojë nga krijesat tjera është njeriu.

Zoti xh.sh. në lidhje me krijimin e njeriut thotë:

"Vërtet Ne e krijuam njeriun në formën më të përsosur". (Et-Tinë 4).

Kjo është një prej argumenteve ku Zoti vërtet na dalloi nga të gjitha krijesat. Para se të krijojë njeriun e parë Ademini a.s. Zoti u tha engjëjve, ku Kur'ani famëlartë na argumenton me ajetin e sures Bekare, ku thotë:

"Kur zoti yt u tha engjëjve: Unë po krijoj një zëvendës në tokë. Ata thanë: A do të vesh në të (tokë) atë që bën çrregullime dhe që derdh gjacket, e ne të madhërojmë ty me lavdërimin tënd dhe plotësisht të adhurojmë. Ai (Allahu) tha: Unë e di atë që ju nuk e dini". (El-Bekare 30)

Pra do të thotë se meritën më të madhe për udhëheqjen e tokës e ka njeriu. Engjëjt së pari nuk qenë të kënaqur me atë që Allahu u tregoi, por duhet pasur parasysh se nuk e kundërshtuan urdhërin e Allahut xh.sh. Por dëshiruan të mësojnë edhe më tepër për aftësitë e njeriut si krijesë fizike e materiale, e cila sipas natyrës së vetë është i gatshëm të bëjë edhe çrregullime në tokë. Mirëpo Allahu xh.sh. i qetëson melaiket atëherë kur u thotë:

"Unë e di atë çka ju nuk e dini". (El-Bekare 30)

Prej shumë të mirave të cilat Zoti xh.sh. ia dhuroi njeriut, më e çmuara është nderimi që iu bë me urdhërin e Zotit nga ana e engjëjve. Për t'u treguar të gjitha krijesave se njeriu meriton vendin më të lartë ndër to, i urdhëroi engjëjt që t'i bëjnë sexhde Ademit a.s. në shenjë nderimi e jo adhurimi. Allahu xh.sh. në Kur'anin famëlartë thotë:

"E kur u thamë engjëjve: Përluni Ademit, ata menjëherë iu përlunë me përjashtim të Iblisit (shejtanit), ai refuzoi e u mbajti me të madhë, dhe u bë pabesimtar". (El-Bekare 34)

Në këtë ajet shohim se engjëjt kryen me përpikëri urdhërin e Allahut me përjashtim të Iblisit, i cili refuzoi dhe Allahu xh.sh. e largoi një herë e përgjithmonë nga mëshira e tij.

Nuk e krijoi Zoti njeriun se ka farë dobie prej tij, apo për ndonjë qëllim tjetër, por vetëm që ta adhurojë Allahun xh.sh. Shih çka thotë ajeti Kur'anor:

"Nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër vetëm që të më adhurojnë". (Edh-Dharijat 56)

Duke kaluar etapë pas etape njerëzit e harruan atë që ishin prositur. filluan të bëjnë çrregullime në tokë, të mos dmë se ekziston një fuqi mbynatyrore e cila mund t'i zhdukë të gjithë dhe nuk është asgjë vështirë për të. Filluan që në vend të krijuesit të tyre të adhurojnë puta të ndryshëm, duke menduar se ata do

t'u ndihmojnë. Por çka? Allahu xh.sh. kurënjëherë nuk reagoi me të shpejtë që t'u hakmerret, por për udhëzimin e tyre zhgjidhi njeriun nga mesi i tyre i cili do t'ua rikujtojë fenë e mëparshme. Pra dergoi pejgamberë, ku ua tërheqnin vërejtjet, e pastaj ata që besonin, shpëtonin, ndërsa të tjerët dënoheshin nga Allahu xh.sh.

Marrim shembull të Nuhi a.s. ku edhe djali i tij u fundos në ujë për shkak të mosbesimit. Veprime të tilla patën edhe shumë popuj të tjerë, por me ardhjen e Muhamedit a.s. ndryshoi krejtësisht gjendja.

Muhamedi a.s. që shëmbulltyrë e njerëzimit i cili me bindje dhe butësi, vërtet arriti kulminacionin me të madh gjatë historisë njerëzore. Dhe sot e kësaj dite emri i tij u shpërnda në tërë rruzullin tokësor e më gjerë, ku në Kur'an thuhet:

"Dhe Ne të ngritëm lart famën tënde". (El-Inshirah 4).

Nga gjithë kjo që tham më parë Allahu xh.sh. deshi që gjithëherë njeriun ta ngrisë në një shkallë të lartë. Edhe pse njeriu nuk qe besnik ndaj urdhërave të Zotit i cili për të mirën e tij e urdhëroi që ai t'i kryejë. Marrim një shembull.

Në qoftë se ankon prej një sëmundje dhe njeriu prej mjekëve arrin që të shërojë, atëherë ti do të përpiqesh që atë ta nderosh dhe t'i dhurosh dhurata të çuditshme. Kështu qëndron puna edhe me krijimin tonë. Duhet që Allahun ta nderojmë me namaz dhe me disa punë të tjera, ngase mjeku në krahasim me Allahun nuk është asgjë. Atëherë ku mund që t'i japim drejt veti dhe mjekun ta nderojmë me shumë se Allahun?

Mirëpo ku jemi ne të cilët, lere më që nuk na bie ndërmend për Allahun, por mundohemi që ta demantojmë në përgjithësi fjalën e Allahut. duke kërkuar që populli të edukohet në frymën jofetare. Me shumë gieste i afrohem atyre që dëshirojnë të zhdukin islamini nëjherë e përgjithmonë në sipërfaqen e tokës. Me gieste jo të mira duke refuzuar çdo mësim fetar, duke ushmangur nga rruga e Allahut, e në fund presim që Allahu të na ndihmojë. Për Zotin kurë nuk do të na vijë ndihma e Allahut përderisa ne t'i nënshtrohemi atij. Desha të them se afërsia më e madhe të Zotit është namazi.

Mendojmë se Zoti nuk na dëgjon dhe shëh se çka veprojmë. Shpeshherë e ndyejmë gjuhën tonë duke thënë se Zoti nuk po na ndihmon, ndërsa vetë as që i kemi veprat për të na ndihmuar. E refuzuam muslimanin i cili na udhëhoqi 500 vjet ndërsa tash i ofruam pabesimtarin. Duhet të kemi parasysh fjalën e Pejgamberit a.s. i cili ka thënë: "Ashtu si jeni ju, e keni edhe sunduesin tuaj".

Pra t'i kthehem edhe njëherë fesë së drejtë dhe të vërtetë e cila na ruajt gjuhën dhe kombin, e të mos ecim rrugës së huliganëve të botës. E mira jonë është që ta mbajmë titullin që na dhuroi Zoti xh.sh. na i falë gabimet, bëjmë lutje që të na udhëzojë në rrugë të drejtë, dhe të bëhemi njerëz të devotshëm ashtu siç na ka hije. Të bëhemi ata të cilët që në qoftë nevoja, ta flijojmë jetën për Allahun. Dhe në fund porosi e imja do të ishte që të ruajmë emrin që na dhuroi Allahu, pra emrin njeri.

Punoi: Adnan Berbatovci Kl. III-a

A n k e t ë A n k e t ë A n k e t ë

Në këto kohëra të vështira, kur heshtja ka pllakosur çdo gjë, e armiku na rri mbi kokë si një kulqedër e tërbuar duke mbjellë dhunë, terror, vrasje e maltretime, ku atdheu ynë Kosova është e okupuar nga thundra e tiranëve të Karpateve e ne si popull po përjetojmë kriza të vështira ekonomike-sociale, kulturore, arsimore, fetare etj.

Shkolla jonë Medreseja, po e ndanë fatin me simotrat e saja kudo në Kosovë, mirëpo ajo diti të jetë fole dhe çerdhe e çdo përpjekjeje liridashëse, duke hapur krah e krah dyert e saja për bijt dhe bijat e popullit tonë.

Dikur në kohën e monizmit Medreseja në sytë e disave ishte një shkollë e përbuzur dhe gjithnjë shikohej me nënçmim, por deshti Zoti i Plotfuqishëm kohrat ndryshuan, edhe Medreseja fitoi tretmanin dhe pozitën që vërtet i takon. Kështu që tash për t'u ulur në bankat e saja ekziston një konkurrencë tejet e fortë, ku për një vend konkurojnë shtatë deri në tetë kandidatë.

Megjithëse ky institucion fetar ka edhe kovinktin me të gjitha kushtet e parapara për nxënës, ku ndër tjera posedojnë edhe restorantin, sallën sportive, amfiteatrin, bibliotekën, sallën e leximit dhe me një fjalë i ka të gjitha kushtet normale për përgatitjen e nxënësve.

Duke u bazuar në këtë, revista jonë bëri një anketë të vogël me nxënës që të njihet gjendja reale si në mësim ashtu edhe në fushat tjera.

Drita e Kur'anit: *A jeni të kënaqur me organizimin e jetës në Medrese?*

Dy të tretat e nxënësve u përgjigjën në mënyrë pozitive duke u arsyetuar me atë se në Medrese janë organizuar lloj lloj dramash, recitalesh të niveleve të ndryshme, gjithashtu edhe nga vetë nxënësit e shkollës ka pasur programe edhe shfaqje kulturore si dhe organizime tjera. Ndërsa pjesa tjetër u përgjigjën në mënyrë më të zbehtë duke thënë se organizimet nga vetë ana e nxënësve dhe kryesisë së tyre duhet të jenë më të shpeshta dhe aktivitetet sportive të jenë në nivel të duhur. Mirëpo pasi që salla e sportit shfrytëzohet pjesërisht, ngase është e dëmtuar, është dashur që aktivitetet tjera të jenë më prezente. Por ata na thanë se jemi thellë të bindur në rregullimin e ketyre mangësive pasi që edhe drejtorja ka shprehur një interesim shumë të madh për kërkesat e nxënësve.

D. e Kur'anit: *Ju si nxënës e dini rëndësinë e kohës, andaj e shfrytëzoni atë sa duhet?*

Shumica prej tyre janë të mendimit se edhe pse e dinë rëndësinë e kohës prap ata nuk e shfrytëzojnë ate sa e si duhet, edhe pse kushtet ofrojnë një gjë të tillë prapë nuk janë mjaft të kujdesshëm deri në maksimum ndaj saj, sepse mungon bindja se koha është si shpata, nëse nuk e shfrytëzon atë ajo të mposht. Mirëpo sido që të jetë ajo shfrytëzohet mjaft.

D. e Kur'anit: *Nëse rezultati i suksesit nuk është aq pozitiv për t'i përbushur kërkesat e së ardhmes, atëherë si do të mund të vijë deri te përmirësimi i tij?*

Shumica dërmuese e tyre mendojnë se sukcesi do të jetë edhe më i lartë vetëm atëherë kur shfrytëzohet studimi sa duhet, i cili është edhe obligim i tyre dhe nëpërmes tij arrihet shprehia e punës për tërë jetën. Njëherit edhe përmbajtja e rendit shkollor do të ndikonte më tepër në interesimin e nxënësve për të krijuar bindjen se vetëm puna sistematike do të nxjerrë në dritë duke e kryer emanetin e marrë, e njëherit do të krijojmë perspektivën e së ardhmes.

D. e Kur'anit: *A keni kohë të mjaftueshme që të mirreni edhe me aktivitete të tjera, pasi që jeni të ngarkuar mjaft shumë me mësim?*

Meqenëse jemi të angazhuar mjaft shumë me mësim, prapëseprapë e gjejmë kohën e lirë për t'u marrë me aktivitete tjera si nga jeta kulturore njëashtu edhe nga ajo sportive.

D. e Kur'anit: *Duke pasur parasysh se planprogrami mësimor është i ngarkuar mjaft shumë me lëndë fetare e shkencore, mendoni se ndonjë prej tyre është e tepërt që të largohet apo të zëvendësohet me ndonjë tjetër?*

Sa i përket kësja pyetje nxënësit potencuan këtë:

Pasi që ne jemi të angazhuar më tepër me lëndë fetare, dëshirojmë që ato t'i mësojmë maksimalisht pasi që jemi orientuar në këtë profesion. Interesimi nuk mungon as ndaj lëndëve tjera sepse duhet të pajisemi me njohuri të fushave të ndryshme dhe kështu të formojmë një dije sadopak univerzalve. Mendojmë se disa prej lëndëve janë të tepërta dhe kemi dëshirë që të zëvendësohen me lëndë tjera, e në veçanti të futet lënda e Informatikës në të gjitha vitet.

D. e Kur'anit: *Ku mendoni të regjistrohemi pas mbarimit të Medresesë, të vazhdoni këtë drejtim, apo të orientoheni në ndonjë tjetër?*

Ata u përgjigjën:

Jeta e Medreses është shumë e lumtur dhe entuziaste për ne, shumica prej nesh do të vazhdojmë drejtimin që e kemi zgjedhur dhe jemi të bindur se atë që e kemi mësuar në Medrese nga parimet e shenjta Islame janë të kalitura në shpirtërat dhe zemrat tona, me anë të të cilave do të kontribuojmë për këtë popull. Kështu me atë që fituam në Medrese mendojmë ta vazhdojmë edhe Fakultetin Teologjik që falë Zotit xh.sh., tash ekziston edhe në Prishtinë.

Nga anketa me nxënësit shihet se me të vërtetë në Medrese lulëzon jeta fetare, kulutorore e shkencore. Nëpërmes kësaj anketete të vogël shihen cilësi morale, solidarë dhe gatishmëria e tyre për të kontribuar në ngritjen e vetëdijes së popullit si në aspektin fetar gjithashtu edhe në ate kombëtarë.

Anketuan: Jakup Çunaku IV-b

Adnan Simnica IV-a

MBULESA ISLAME - HIXHABI

Është e vërtetë dhe e pamohueshme se jetojmë në kohën e të gjitha formave të paturpësisë dhe pornografisë. Për më tepër shtazërimi i njeriut ka marrë shenjën mbrojtëse të përparimit dhe modernizimit. Besimtarët në këtë kuptim askush as që do t'i kuptojë. Përkundrazi, sa do të jetë e mjaftueshme, nëse besimtarët e kuptojnë në mënyrë të drejtë pozitën e tyre të tillë në një botë të tillë.

Sheriati Islam i ka dhënë rëndësi shumë të madhe gruas muslimane, me qëllim që ta mbrojë gjininë e saj, ta bëjë krenare dhe me pozitë të rëndësishme në shoqërinë ku jeton. Të gjitha kufizimet që i janë bërë në veshje dhe zbulimin e saj, janë bërë me qëllim që t'i mbyllin dyert e çorodisë dhe të imoralitetit, të cilat përhapen nga lakuriqësia dhe shfaqja e bukurisë. Këtë që e bëri islami nuk e bëri me qëllim të kufizimit të të drejtave të njeriut, posaçërisht femrave, por mbrojtje nga rënia e saj në gropën e nënçmimit dhe të pavlerës.

Këto shkaqe dhe disa të tjera na zgjuan mendjen (na shtynë) që të mendohejmë që në pika të shkurtra ta shtjellojmë temën mbi vlerën e hixhazit (mbulesës në Islam), të nxiturit në të, përfundimin e mirë për ata që e praktikojnë këtë urdhër dhe shëmtimin e lakuriqësisë, të tërhequrit vërejtjen nga kjo vepër si dhe tregimi i përfundimit të keq të individit që vepron kështu në dunja dhe ahiret. Allahu i madhëruar më së miri e di qëllimin tonë.

Për dallim nga të gjitha qeniet tjera të gjalla, i vetmi njeriu, sipas urdhërit dhe udhëzimit të Allahut xh.sh., vishet dhe me robet e tij mbron trupin e vet dhe i mbulon vendet e turpshme.

Pasiqë shpesh në literaturën dhe të folurit tonë përdoret shprehja "mbulesa e femrës" është e nevojshme të tregohet të kuptuarit më preciz të konceptit për të cilin është fjala. Duke marrë parasysh në frymën e Islamit, domethënien esenciale të fjalës "mbulesa" dhe rëndësinë e saj të përdorimit, patjetër duhet të tregojmë si vijon. Vetë fjala "të mbulosh" d.m.th.: t'i vesh diçkasë përsipër diçka; të mbrorsh diç me diç; të fshehësh diç etj.

Te ne, me të mbuluarit e femrës më së shpeshi nënkuptohet mbulesa e kokës flokëve si: shalli, shamia, ruba, namazbezi etj, të cilat vëhen në kokë, gjë që s'ka pikëmbështetje në burimet themelore të Islamit, sepse domethënia dhe të kuptuarit islam të këtij koncepti është më i gjerë dhe nënkupton tërë trupin e femrës me disa përjashtime për të cilat do të flasim më vonë.

Njeriu e mbulon trupin me rroba, kurse shpirtin me turp. Këto fjalë gjejnë mbështetje në hadithin e Pejgamberit

s.a.v.s. i cili thotë: "Trupi është zbulim, devotshmëria është fisnikërim, mbështetja më e mirë në jetë është durimi, kurse të priturit ndihmë nga Allahu xh.sh. në situatë të vështirë është ibadet" ose më shkurt: "turpi është nga imani".

Mbulimi i vendeve të turpshme është obligim-farz si për meshkuj ashtu edhe për femra.

Çdo musliman e muslimane duhet të jenë të vetëdi-



jshëm, se duhet të ulin shikimet dhe t'i mbulojnë vendet e turpshme sepse kështu urdhëron Allahu: "thuaje (O Muhammed) besimtarëve le t'i ulin shikimet e tyre dhe le të kujdesen për mbulimin e pjesëve të turpshme të trupit të vet. Ajo është më e pastër për ata. Allahu me siguri e di se ç'punoni ju". (En-Nur 30)

Gjithashtu Allahu xh.sh. në një ajet tjetër thotë:

"Thuaje besimtareve le t'i mbulojnë krahërorët e tyre me mbulesa dhe mos t'ua tregojnë zbulimet e tyre askujt, përveç bashkëshortëve të tyre ose baballarëve të burrave të tyre ose djemëve të vet ose djemve të burrave të tyre..." (En-Nurë 31)

Pra burrat, e edhe gratë, kategorikisht urdhërohen që të kenë kujdes të përherëshëm mbi vendet e turpshme dhe që t'i ulin shikimet e tyre e jo që të drejtojnë shikimet plot afsh në njëri tjetrin. D.m.th. prej shikimit fillon dhe bëhet çdo gjë.

Grave reptësisht u urdhërohet mbulimi i zbulimeve të tyre dhe lëshuarja e mbulesave në krahëror. Menjëherë mund

të themi se mbulimi është obligim, e jo arbitrar "dua", "s' dua".

Mund që ta shtrojmë edhe këtë pyetje: Prej kur femra është e obliguar që të bartë mbulesën-hixhabin? Si argument për këtë marrim hadithin e Pejgamberit a.s. i cili me një rast i kishte thënë Esmës bijës së Ebu Bekrit: "Oj Esmë, kur të hyjë femra në pubertet, nuk është e lejuar t'i shihet asgjë përveç kësaj (duke i treguar fytyrën dhe duart)". Gjithashtu Pejgamberi a.s. e ndaloj veshjen me rroba të ngushta.

Islami kërkon nga muslimani - muslimaneja që të shmangen situatave, në të cilat vështirë ose asesi nuk do të mund t'i bënin ballë sprovës së shejtanit, kënaqësisë së epsheve që nuk janë në pajtim me parimet morale islame.

Në këtë kuptim dhe në këtë qëllim, Kur'ani i caktoi parimet e veshjes islame, kurse Pejgamberi a.s. i shpjegoi dhe praktikisht i zbatoi.

Kur'ani qartë thotë:

"O ti Pejgamber, thuaju grave tuaja, bijave tua dhe grave të besimtarëve le t'i vëjnë shamitë (mbulesat) e veta mbi trupin e tyre, pse kjo është më afër që ato të njihen se nuk janë rrugaqe e të mos ofendohen. Allahu fal gabimet e kaluara. Ai është mëshirues."

Pastaj verseti tjetër: "Dhe rri në shtëpitë tuaja e mos e shfaqni bukurinë tuaj siç shfaqej në injorancën e hershme".

Rreth kësaj teme kemi shumë ajetet që i shpalli Allahu xh.sh., por jam i bindur se sigurisht do të mjaftojnë të lartpërmendurit.

Në ajetet e përmendura, Kur'ani së pari i konfirmon përgjithësisht arsyet e veshjes në mënyrë që në fund t'i obligojë muslimanet që t'i mbulojnë të gjitha, përveç asaj që edhe ashtu është e jashtme. Përcaktim më preciz në Kur'an nuk ka!

Gjithashtu rreth mbulesës islame kemi një numër të mjaftueshëm të haditheve të Pejgamberit a.s.. Sejjid Kutubi duke folur për mbulesën, thotë se këtë më së miri e ka shpjeguar vetë Muhammedi a.s.: Ajsheja transmeton:

"Njëherë motra ime Esmaja hyri te Pejgamberi i Allahut me fustan të rrallë dhe të tejdukshëm, nëpër të cilin shihej trupi i saj. Pejgamberi i Allahut e ktheu kokën dhe tha: "Oj Esmë, kur të hyjë femra në pubertet s'është e lejuar t'i shihet asgjë përveç kësaj (dhe e tregoi fytyrën dhe shuplakat)!" (Transmeton Ebu Davudi).

Pra dije oj motër muslimane se hixhabi është besim, është për ato që turpërohen, është nder, është pastërti etj. Pejgamberi a.s. thotë: "Allahu i Lartëmadhëruar është i Turpërueshëm dhe i Mbuluar dhe e do turpin dhe mbulesën!"

Mbulesa është në përputhshmëri me xhelozinë (e lejuar), e cila është prej natyrës së burrit të drejtë, i cili nuk toleron që të hidhen shikime përvjedhëse nga gruaja ose

bijat e tija. Shumë luftëra kanë filluar mu për shkak të tradhëtisë së gruas, që ka filluar me shikim të thjeshtë. Aliu r.a. thotë: "Më kanë treguar se gratë tuaja përzihen me burrat e huaj në treg (pa prezencën tuaj)? A nuk keni xhelozia? Nuk ka hajr prej atij që nuk xhelozon për të mirë!"

Kuptohet, xhelozia ndaj gruas së pafajshme dhe të ndershme nuk preferohet, por duhet patur gjithmonë kujdes nga cytjet e shejtanit të mallkuar.

Lakuriqësia ka edhe dëmet e saja, disa nga ato dëmë janë: Lakuriqësia është prej mëkateve shkatërruese, ajo shkakton mallkimin dhe largimin nga mëshira. Lakuriqësia është prej cilësive të banorëve të zjarrit, ajo është dyfytërsi, është turp, është zina (imoralitet), është pasim i shejtanit. Lakuriqësia është rruga e çifutëve, lakuriqësia është injorancë dhe prapambeturi etj.

Pra motra ime muslimane, a nuk dëshiron të kuptosh fjalën e Pejgamberit a.s.: "Largo pengesën nga rruga e muslimanëve", por gjithashtu a nuk dëshiron ta kuptosh edhe fjalën e Allahut xh.sh. që thotë: "Prandaj, mos u frikësoni nga njerëzit, vetëm Mua të më frikësoheni dhe mos i ndërroni argumentet e Mía për pak send". (Suretul-Maide 44).

Pra robi është i obliguar që t'i zbatojë urdhërat e Allahut dhe të dërguarit të tij, duke mos u frikësuar nga askush nga krijesat, por duke pasur frikë dhe respekt vetëm ndaj Allahut xh.sh..

Veshja Islame e mbron trupin dhe shpirtin. Ajo mbron moralin e atij që e mban. Veshja Islame është rruga për në xhennet. Parimet e saja janë nga Allahu xh.sh. e s'janë nga njerëzit, nuk janë të burimit e të karakterit të kufizuar. Janë univerzale dhe përjetësisht të vlefshme (aktuale)! Të pandryshueshme!

Lëvizjet bashkëkohore në botën Islame tregojnë se rinia po bëhet e vetëdijshme që vetëm transofmimi i tërësishëm i jetës dhe harmonizimi i saj me parimet morale islame mund të sigurojë lumturi e kënaqësi të vërtetë. Vajzat e Azisë, Afrikës, Evropës... me plot arsye i përvetësojnë gjithnjë e më shumë parimet e veshjes që i ofron Kur'ani dhe sunneti. dhe në fund një pyetje (Oj motra ime muslimane): A do ta çosh në vend urdhërin e Allahut dhe të Dërguarit të Tij? Vëre pra hixhabin (mbulesën) në trupin tënd, sepse kjo është më e mirë për ty nëse e di. Dhe së fundi po e përfundoj këtë koncept duke cekur një ajet kur'anor:

"Dëgjua dhe respektua (urdhërin). Kërkojmë faljen Tënde, O Zoti ynë! Vetëm te Ti është përfundimi ynë!" (El-Bekare 285).

E punoi: Burhan Hoxhaj K. IVb

Në shtëpi kemi një problem

Kur nënshkrova aktin e parë të martesës para një viti të gjithë ata që i njihja shoqe e farefis më ofruan njohuritë dhe përvojat e tyre. Njëra thoshte bëj kështu, e tjetra ke kujdes këtë vepër, e treta jepte disa këshilla për të cilat nuk kisha nevojë, edhe pse unë u pata thënë se nuk dua përvoja të mëparshme, unë kam personalitetin tim të pavarur, gjë e cila më mundëson të zbuloj jetën time dhe të sillem me të (jetën) ashtu si më konvenon, mirëpo çdokush prej tyre u mundua të më mësojë me përvojën e vet. Mendoja se jeta bashkëshortore është përplot ideale dhe me sjellje të rangut të lartë. Mendoja se çdo problem që ndodh, nëse ndodh, edhe pse unë nuk besoja se do të paraqitej ndonjë problem, do të zgjidhet me bindje, ose me bind me logjikë, ose e bindi me logjikë.

Kështu zgjidhet problemi. Së paku kështu mendoja. Problemin e parë që më ndodhi në jetën bashkëshortore deshirova ta zgjidh duke përdorur metodat ideale, mirëpo nuk korra sukses, as unë s'e binda burrin e as ai s'më bindi mua. E kur arriti polemika në udhëkryq, e pashë të arsyeshme që ta ndërpres polemikën, meqë pash se nuk ka rezultat. Të njëjtën gjë e bëri edhe ai. Kështu ndodhi përleshja e parë në jetën time bashkëshortore, ku mendoja si disa që do të vjen rasti të ketë mosmarrveshje. Kjo gjendja zgjati dy ditë derisa burri im e zgjodhi këtë problem me një dhuratë modeste dhe më tha se kështu nuk duhet të rrjedhin ditët e para të jetes sonë bashkëshortore. Mirëpo me gjithë këtë, kjo gjendje nuk zgjati shumë kohë. U shkaktua edhe problemi tjetër dhe normalisht edhe polemika tjetër, gjë e cila zbuloi mosqëndrimin e bindjeve të mia me të cilat i bëra një hyrje jetës sime, dhe prita që ai të fillojë pajtimin siç bëri herën e kaluar, ngase fisnikria ime nuk lejonte që unë të kërkoj kënaqësinë e tij. Kështu edhe ndodhi, lëshoi pe dhe e zgjidhi problemin. Mirëpo nuk gjetëm zgjidhje të logjikshe për zvoçlimin e mospajtimeve, përkundrazi secili prej nesh u bë tejet i ndieshëm ndaj tjetrit. Kështu vazhdoi një kohë derisa lindi një problem i madh, dhe që të dy u bindëm se nuk mund të arrijmë në mirëkuptim për këtë çështje. Do ta konsidroja veten të drejtë nëse pranoja se unë isha shkaktare për lindjen e problemit derisa doli burri im prej shtëpie. Gjatë kesaj kohe mendova me seriozitet për jetën tonë bashkëshortore.

Më në fund kuptova se idealizimi për të cilin fola pak më parë është i paarritshëm dhe se patjetër duhet të

ketë probleme në shtëpi, e nëse ka probleme doemos duhet të ketë edhe zgjidhje për to. Në këto çaste shpresova që shoqet dhe farefisi të m'i përsërisin këshillat që m'i dhanë më parë. Fillova t'ju bëj telefonë njerëzve më të cilët mund të konsultohesha për këto probleme. Kurse burri im gjatë kesaj kohe nuk vinte në shtëpi, përpos në mbrëmje për të fjetur. Nuk hante në shtëpi, nuk më jepte selam, e ajo që më hidhëroi më tepër ishte fjetja e tij në sallonin e shtëpisë dhe injorimi i tij ndaj meje. I thashë vetvetës së kështu do të kalojë dita e parë e nësër do të lëshojë pe dhe do të pajtohem, e kështu do të marrë fund problemi. Pas këtij mendimi u qetësova dhe më zuri gjumi. Kaluan dy-tri ditë, kurse asgjë nuk ndryshoi. Nuk lëshoi pe dhe problemi mbeti i pazgjidhur. Fillova të nërvozohem dhe të llogaris çdo dalje, ku han, ku pi, me kë fle, edhe pse isha e sigurt se nuk e ka informuar askënd prej familjes së tij dhe familjes sime, ngase qysh në fillim kishim lidhur kontratë për këtë gjë. Fillova të kërkoj zgjidhje për këtë problem dhe t'i analizoj porosinë dhe propozimet e shoqeve. Filaneja thoshte, mos kërko pajtim që të mos llastohet e të prish jetën tënde... Mendova për qëndrimin e tij kur lëshoi pe dhe u pajtua me mua, atëherë i thashë vetvetes pse mos të lëshoj pe unë dhe të pajtohem. Mirëpo epshi nxitës për të keq më thoshte a s'e harrove fisnikrinë tënde. Jo. Jo. Mos lësho pe. Ai është burrë, ai duhet ta zgjidhë problemin. Shoqja tjetër më thoshte Pse nuk mundohesh ta zgjedhish problemin, ti je shkaktare. Duhet të kërkosh falje dhe të mbaron çdo gjë. Nuk u ndryshua në jetën tonë diç vetëm se në këtë gjendje. Pyeta vetveten shumë herë: a je ti grua ideale!

Ndërgjegjja më qortonte. Mundohesha të largoj mërzinë me lëxim të disa librave. Mirëpo gjatë leximit më paraqiteshin në fantazinë time pamje prej ndarjeve bashkëshortore, dëgjoja aktoren se si thotë: mire, bën divorc, unë nuk do të kërkoj falje. Riktheva këto pikëpamje në përbuzje më dukej se ikja nga realiteti im. Fillova të ndjej se kapem për fijen e kashtes së shpëtimit, të ndihem se po vrapoj nga ajo fije e kashtës së shpëtimit. Po, kjo është ajo që e kërkoi. Dua të jem bashkëshorte dhe le të shkatërrohet shejtani. E dëgjova këtë thënie në veshin tim dy-tri herë derisa e mësova përmendësh. Mund të paramendonisa u gëzoja kur gjeta zgjedhje për këtë problem. U vesh

me rroba dhe u zbukurova u parfumosa, duke marrë thellë nga era e parfumit, i cili më parfumosi jetën para se të më parfumos rrobot. Kur hetova çelësin që lëvizte në derë, mblodha guximin dhe iu drejtova burrit tim, i cili ishte futur në shtrat. Pasi që e kapa për të dy duart i thashë: Pejgamberi S.a.v.s. thotë: "Gratë e juaja të dunjasë do të jenë gra të juaja në xhenet. Të dashura dhe që lindin. E kur hidhërohet burri i saj vendos dorën e saj në dorën e tij dhe thote: Nuk më ze gjumi derisa të jesh i kënaqur". Ja unë kërkoj lutje. Burri im u habit, mbeti pa fjalë, nuk u besonte veshëve të vet.

Nga ky çast ndodhi ndryshimi i madh në jetën tonë, ELHAMDULIL-LAH. Ju them me sinqeritet, nuk u gëzova aq më zgjidhjen e problemit sa u gëzova me këtë këshillë pejgamberike, të cilën Pejgamberi a.s. e ka thënë para katërmbëdhjetë shekujve, kurse unë sot po e përfjetoj ndikimin e saj. Kur vendosa duart e mia në duart e tij hetova

ndikimin e madh që ka prekja në shuarjen e hidhërimit, ndoshta edhe vetë teksti i hadithit ndikoi, sa që m'u duk sikur shi i cili luan hidhërimin nga zemra e tij që e kishte në brendi.

Në këtë çast hetova se unë jam me vlerë edhe pse isha gabimtare. I premtova vetvetes se çdoherë do t'i zgjedh problemet e mia duke e zbatuar këtë rregull. Lus Allahun xh.sh. që mos të ndodhë kjo asnjëherë meqë e kuptova këtë hadith sherif.

Pejgamberi s.a.v.s. thotë:

"Nëse një grua lutet në pesë namazet, agjëron ramazanin, ruan nderin e saj edhe e respekton burrin e saj, hyn në xhenetin e Zotit të saj.

Shkruan: - Ummul-Beraa. Marrë nga revista "El usreh"

Përgatiti EROLL REXHEPI kl, IV/a

K ë s h i l l i m i

I qofshim falë All-llahut të Plotfuqishëm, Krijuesit të të gjitha botërave. Dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç All-llahut dhe se Muhamedi është i dërguari i tij. Falenderojmë All-llahun xh.sh. që na e shpalli Kur'anin lamelartë, në të cilin këshillohemi për çdo gjë.

Një nga punët shumë me rëndësi në fenë islame, është edhe këshillimi dhe marrëveshja. Nëse besimtari apo besimtarja vendos që të kryejë një vepër të rëndësishme, është e preferuar nga mësimet islame që të këshillohet apo të kërkojë mendimin e miqve të afërt ose të dijetarëve. Njerëzit gjithmonë kanë gjetur zgjidhje më të mençur kur ata mes veti janë këshilluar, sesa individit vetë.

"... Andaj ti falju atyre dhe kërko ndjesë për ta, e konsultto me ta në të gjitha çështjet..." (Kur'an, 3:159)

Një as-hab tregon: "Kurrë nuk kam parë njeri që të pyes aq shpesh për këshilla, siç bënte i dërguari i Zotit Muhamedi a.s. Pejgamberi një herë i tha Ebu Bekrit dhe Omerit r.a.: "Nëse ju të dy pajtoheni për diçka, unë nuk do t'ju kundërvihem".

Kur erdhi i dërguari në Medinë, u shtrua pyetje se si të bëhet thirrja për namaz. Pati shumë propozime të ndryshme, si: ndezja e zjarrit, rënia e kumbonës etj. Njëri nga të pranishmit në konsultim, rrëfen se në ëndërr kishte mësuar se muslimanët duhet të thirren në namaz me fjalën e gjallë të nejrut. Resulull-llahu dhe të pranishmit tjerë e miratuan këtë propozim dhe që nga atëherë ekziston ezani.

Pejgamberi a.s. ka thënë:

"Kush mendon të bëjë një punë dhe këshillohet me njerëzit e mençur dhe me njerëzit që kanë përvojë, All-llahu do ta bëjë ashtu që për të të jetë më së miri. Besimi është të

këshilluarit në çdo punë për të mirë, Suksesi është i sigurt në çdo punë, nëse këshillohet me njerëz të mençur. Kush këshillohet, ai fiton. Nuk ka të mira nëse njerëzit nuk këshillohen. All-llahu çmon lart marrëveshjen në të gjitha punët".

Shpeshëhere shohim njerëz të cilët pa u këshilluar me askë marrin vendime në punët më të rëndësishme të kësaj jete. Këta janë shpirtëra egoiste, të cilët kurrë nuk gjejnë zgjedhje të drejtë e të lumtur, por gjithmonë sillen rreth mendimeve të veta, qofshin ato edhe të gabuara. Në zemrat e tyre nuk ekziston ngrohtësi të mirëfilltë njerëzore që mund të ngrohë edhe zemrat tjera.

Ata të cilët gjatë jetës së tyre janë këshilluar dhe kanë vepruar sipas këshillave të të urtëve dhe të të mençurëve i kanë hapur vetit rrugë të ndritshme. Pra besimtarët duhet të veprojnë kështu. Për këshilla duhet të pyesin prindërit, të afërmit, të diturit, miqtë e kështu me radhë.

Gjithmonë, para së gjithash, këshillën duhet kërkuar nga burimet islame, sepse islami jep përgjigje në të gjitha pyetjet, në të gjitha problemet. Jep udhëzime që shpiejnë drejt zgjedhjeve në të mira. Kjo këshillë duhet të kërkohet në Kur'an, hadith, si dhe në praktikën islame.

O Zot, bëna prej atyre që gjithmonë të këshillohemi mes veti, sepse Ti je i mëshirshëm dhe mëshirën Tënde ua fal besimtarëve.

Besim Limani Kl. IV/b

IBNI KAJJIM EL-XHEVZI

Kujdesi dhe vëmendja për fëmijërinë

Njëri prej dijetarëve më të shquar islam në shekullin e VII sipas hixhretit, Ibni Kajjim el-xhevzi, në librin e tij "Tuhfetul mevdudi bi ahkamil-mevludi", ka vënë në pah se ekzistojnë rregullat në lidhje me fëmijun derisa ende është embrion në barkun e nënës, pastaj për periodën e zhvillimit-pubërtetit, për moshën madhore e deri te fundi i jetës, e edhe më pas. Këto rregulla duhet të sigurojnë kushte të volitshme për pjekurinë e tij shëndetsore, shpirtërore dhe intelektuale. Gjithsesi vëmendja dhe ruajtja e nënës, gjendja e saj shpirtërore dhe shëndetsore është gjëja më e rëndësishme për të.

Me këto studime ky dijetar i madh islam i ka tejkaluar psikologët e kohës moderne, të cilët shpjegojnë se kujdesi për "ambientin e mitrës" është faktor jashtzakonisht i rëndësishëm për ruajtjen e fëmijut para ardhjes së tij në këtë botë. Nëse shtatëzënisë i kushtohet kujdesi dhe vëmendja e mjaftueshme, siç thotë El-Xhevzi, dhe fëmija do të vijë në këtë botë pa kurrfarë deformimesh dhe anomalish. Mirëpo, El-xhevzi nuk ndalet në këtë, por thekson se dëshira për lindjen e fëmijëve gjithashtu është faktor i rëndësishëm, se ajo është faza e përgatitjes shpirtërore për prindërit.

"Të mjerë janë fëmijët, prindërit e të cilëve nuk janë në shkallën më të lartë të gëzimit për ardhjen e tyre në këtë botë" - thotë Ibni Kajjim El-xhevzi.

Rreth dhënies së përparësisë së fëmijës mashkull ndaj atij femër, El-Xhevzi merr qëndrim energjik se ajo është në kundërshtim me mendjen e shëndoshë dhe me parimet islame dhe se trajtimet e tilla shkaktojnë sëmundje të ndryshme shpirtërore dhe trupore. Duke pasur parasysh se fëmijët e të dy gjinive janë mirënjohje e Allahut, duhet t'i japim emrat e mirë. Aty përjashtohet çdo mospajtim në mes prindërve, sepse Kur'ani është kaetgorik dhe i qartë që fëmijët të thiren sipas prindërve të tyre;

"ju thirrni ata (fëmijët) në etërit e vërtetë të tyre, kjo është më e drejtë tek Allahu". (El-Ahzab: 5)

Sa i përket fazës së adaptimit shoqëror të fëmijëve, Ibni Kajjimi atë fazë e konsideron program i "dirigjimit të fëmijërisë", kurse ky program është i përbërë prej:

- nevojës së domosdoshme të nënës që të sillet me butësi dhe dashuri ndaj fëmijëve, duke përfshirë aty puthjet dhe përkdheljet;

- edukimit dhe arsimimit të fëmijëve në baza të drejta (në vështrimin e lejimeve dhe ndalimeve).

Në këtë drejtim Ibni Kajjimi ka përpunuar shumë pyetje rreth të cilave duhet pasur kujdes me rastin e edukimit të fëmijëve. Nga ana tjetër Ibni Kajjimi kërkon që p.sh. taitja (gjdhënia) e fëmijëve kryesisht të bëhet në mënyrë të natyrshme, që fëmijet të mos barten pa i mbushur tre muaj, që ushqimi i të posalindurit kryesisht të jetë qumësht, për shkak të lukthitë të dobët dhe paaftësisë së tretjes së ushqimit, derisa nuk dalin dhëmbët, të cilët fal mençurisë së Allahut rriten krahas me zhvillimin e sistemit për tretje. Pas kësaj gradualisht fëmijëve fillohet t'u jipet ushqimi.

Kur është në pyetje zhvillimi i fëmijës El-xhevzi ofron edhe vërejtjet që meritojnë çdo vëmendje:

- kur fillon perioda e të folurit, te fëmija, fjalët e para që do t'i dëgjojë fëmija le të jenë lidhur me Allahun, kurse më vonë ta frymëzojmë gradualisht, të dijë se Allahu është Një, që Ai është pas çdo sendi, që dëgjon të folurit e tyre, që i sheh dhe që është me ta kudo qofshin.

Rëndësi të madhe El-Xhevzi i jep gjdhënies, duke pasur parasysh fjalët e Allahut xh.sh.:

"Nënat, ato që duan ta plotësojnë gjdhënien, janë të obliguara t'ua japin fëmijëve të vet dy vjet të plota". (El-Bekaare: 233)

Gjdhënia në zgjatje prej dy viteve të plota është e drejtë e fëmijës, por nëse prindërit dëshirojnë ta ndërprejnë para se të bëhen dy vjet, atëherë aty duhet pasur kujdes rreth të mësuarit gradual, ashtu që fëmija t'i adaptohet mënyrës së re të ushqimit e cila do të pasojë. Në vështrimin që bën rreth mbrotjes së fëmijës, ky dijetar i ka vënë normat dhe udhëzimet e veçanta:

- rekomandon përmbajtje (masë) në ushqimin e fëmijës;

- të ecurit e hershëm të fëmijës reflekton (pasqyron) negativisht në zhvillimin e tij fizik, e posaçërisht shkakton në zhvillimin e këmbëve;

- ushqimi i planifikuar dhe i rregullt, pastaj gjumi i rregullt dhe mjaftueshëm janë faktorë shumë të rëndësishëm në zhvillimin dhe edukimin e fëmijës.

Mund të vërehet se problemet e fëmijëve në këtë kohë pikërisht kanë të bëjnë në kuadër të atyre që Ibni Kajjim El-Xhevzi mjaft mirë i ka theksuar. thjeshtë fëmijët e kësaj kohe edukohen pa kurrfarë ndalimi apo moslejime, të zgjuar janë deri në thellësi të natës, marrin ushqim kur të dëshirojnë dhe u janë lejuar dëshirës së tyre personale.

Theks të posaçëm El-xhevzi e vë në mënyrë të detyrueshme në edukimin dhe zhvillimin e drejtë të fëmijës që nga perioda e hershme e fëmijërisë së tij. Prej asaj, siç thotë El-xhevzi, në masë të madhe do të ndikojë në tërë ardhmërinë e jetës së fëmijës. Kështu që në vazhdim, ai sjell edhe disa këshilla:

- nuk mund të lejohet që fëmija të qëndrojë në lokalet (hapësirat) e tymosura dhe të dëgjojë diskutimet e shfrenuara të të rriturëve;

- punët e programuara fëmijën e largojnë nga përtacia dhe pasiviteti dhe kalojnë në shprehi që është shumë me rëndësi për fëmijen;

- rreptësisht duhet pasur kujdes që fëmija të mos përdorë atë që do t'ia dëmtojë mendjen e tij, si opiumet e ndryshme e të ngjashme;

- largimi nga të gjitha ato që fëmijen do ta çonin në shfrenim duke e informuar dhe mësuar fëmijen që të sillet mirë në çdo rast, që do të bënte të gatshëm ta kryejë rolin e tij moral dhe shoqëror në harmoni (pa- jtim) me dispozitat e Kur'anit dhe Sunnetit.

Kështu Ibni Kajjim el-Xhevzi na sjell nëpërmjet studimeve dhe veprave të tij një afrim të thellë të periodës së fëmijërisë e cila është pjesë përbërëse, siç i quan terminologjia bashkëkohore "psikologjitë e zhvillimit".

Shqipëroi nga boshnjakishtja:

Adnan Pallça k. IVa

Shkëndijeza Islame

Kush është në të vërtetë i verbër

Në Kairo Emmanuelie Cinquin në një rrugicë e ka vërejtur një plak të verbër dhe gati të paralizuar, me pamje dhe rroba të mjerë. Kur e ka pyetur se ç'po bën aty dhe se a nuk po ndien merzi, ai i përgjigjet asaj derisa, fytyra i ka shkelqyer me ndonjë agim misterioz:

- Jo, fëmij i dashur, unë kurrë nuk merzitem, unë i falenderohem Zotit!

- Për çka po i falenderohesh, babagyjsh, e ka pyetur ajo.

I falënderohem Zotit për rrezen e cila më ledhaton, për zogun të cilin e dëgjoj atje larg, për pulën që e bën vezën, për qiellin e kaltër që të tjerët mund ta shiqojnë.

Unë po jetoj me kënaqësi, Elhamdulillah, perfundoi plaku.

Definitivisht, kush është në të vërtetë i verbër? - pyetet ajo.

Kujdesi

Ahmed ibni Hanbeli në Mekke një pemëshitës ia ka dhënë hua enën (kofen) e vet. Kur ka dashur ta marrë

prapa, pemëshitësi i bjen dy dhe i thotë:- Merre atë që është e jotja.

- Po frikësohem se mos po e marr tënden e për këtë po ta lë.

- Kjo është e jotja, i thotë pemëshitësi, unë kam dashur vetëm të të vërtetoj.

- e nuk do ta marr! tha Ahmedi dhe shkoi.

Dëshirat e zbraza

- Oh, dëshirat e zbraza e kanë shkatërruar këtë botë - ankohej Hasan El-Basri. - fjalë ka por punë s'ka, dituri ka po durim s'ka, besimi ekziston po s'ka besim të fortë.

Çka është ajo?!

Gjithashtu ai ka thënë:

O njeri, jeta është mysafiri yt i cili do të lërë.

Në fund ose do të falenderojë ose do të qortojë (kritikojë).

Gjithashtu është edhe me natën.

(Vijon në faqen 26)

(Vijon nga faqja 25)

Hipokriti dhe besimtari në xhami

- Shembulli i hipokritit në xhami është si shembulli i trumcaku në kafaz: sapo e hapni kafazin, trumcaku fluturon. Shembulli i besmtarit në xhami është si shembulli i peshkut në ujë: me të nuk ndahet: thotë Malik ibn Enesi r.a.

Mendja dhe epshti

Transmetohet se është thënë: "Allahu i ka krijuar engjëjtë prej mendjes por pa epshe, kurse kafshët prej epsheve por pa mendje. Njeriut ia ka dhënë edhe njëren edhe tjetren. Nëse njeriun e mbisundon mendja, është më i mirë se sa engjëjtë, por nëse njeriun e mbisundon epshti është më i zi se sa kafshet".

Shenjat e injorances

Ebu Derda r.a. thotë:

"shenjat e injorances janë: mendjemadhësia, të flasesh shumë pa kurrfarë kuptimi dhe t'u ndalosh të tjerëve diçka, kurse vetë e punon atë".

Për mendjemadhësinë Aliu r.a. thotë:

"Mendjemadhësia është shenjë e mungesës së mendjes".

Më I marri dhe më I mençuri

Thuhet se Aliu r.a. e ka pyetur Amir ibn Murre Ez-zehuriun: Kush është njeri më i marrë? - tha: - Ai i cili për vetveten mendon se është i mençur. - Aliu ia vertetoi këtë, pastaj i parashtron peytjen e dytë.

Kush është njeri më i mençur? - I pyeturi përgjigjet:

- Ai i cili nuk reagon në provokimet e injorantëve...

Respekt mysafirit

Një natë Omer ibn Abdylazizi ka ndejtur me miqtë e vet në banesën e tij. Kur u dobësua drita e fenerit u

ngrit për ta përforcuar personalisht. Njeri nga të pranishmit tha:

- Sundimtar i besimtarëve! Sikur të kishe thënë, çdo njeri prej nesh do të ngritej për ta përforcuar driten e fenerit!

- Omeri tha: - Nuk është nënçmim për sundimtarin që t'i sherbejë mysafirët e vet. - Unë jam ngritur si Omer dhe jam kthyer si Omer.

Dhurata e Pejgamberit

Muhamedi a.s. i ka dhënë Omerit një dhuratë. Me atë rast Omeri i tha: O i dërguar i All-llahut, jepja dikujt që është më i nevojshëm se unë! Pejgamberi i tha: Merre ti atë, e mbajte, apo e shpërndave. Nuk ekziston ai i cili për këtë është më i merituar se sa ti".

Abdullahu i biri i Omerit e ka trashëguar prej babait këtë dhuratë të Pejgamberit a.s., e ka ruajtur me dashuri dhe nuk e ka larguar prej vetës deri në vdekje.

Gjuha prapa Zemres

Te njeriu i mençur gjuha është prapa zemrës. Kur dëshiron të thotë diçka ai se pari mendon mirë, e nëse ajo do të bëhet e dobishme, ai atë e thotë, në të kundërtën ai hesht.

Te injorantet zemra është prapa gjuhes, flet kur dëshiron dhe pa u menduar. (Hasan El Basari)

Letër Prindit

Dr. Taha Hysejni i ka derguar letër prindit të vet me të cilën në mes tjerash qëndronte:

- Baba, më ke këshilluar të mos besoj në gjithçka që degjoj, kurse unë të këshilloj: Mos beso në gjithçka që lexon!

Përktheu nga boshnjakishtja:

Emin Durguti

DETYRAT E NXËNËSIT NDAJ MËSUESIT

Nxënësi duhet ta pastrojë shpirtin dhe zemren e tij nga vetitë e këqia, sepse dituria është ibadet i zemrës. Nxënësi duhet të largohet nga punët që e largojnë nga qëllimi kryesor, sepse mendja, sadoqë të përhapet (hutohet), nuk ka mundësi të arrijë të vërtetën.

Ka qenë traditë e dijetarëve të hershëm (selefus-salihinëve) që diturisë t'i japin rëndësi më shumë se çdo gjeje tjetër.

Dijetari i njohur Ahmed Iben Hambeli për shkak të diturisë e ka vonuar martesën deri në moshën 40 vjeçare.

Transmetohet nga Ebu Beker El Enbari se dikush ia kishte dhuruar një robëreshë. Kur deshi të ketë kontakt me robëreshën, në atë moment atij iu kujtua një çështje e fesë, u largua nga ajo dhe bertiti: shpejt nxirreni jashtë! Anëtarët e familjes e pyetën se çka ka bërë, u përgjegj: Jo, asgjë, mirëpo zemra dhe koka ime u hutua me ty (robëreshen) dhe tha: si të behet që diçka e pavleftë si ti të krahasohet me diçka që është më e vlefshme (siç është dituria).

Duhet që nxënësi t'ia dorëzoj çështjenë e tij, mesuesit të tij, dhe të jetë i thjeshtë para tij, e jo mendjemadh, sikurse i sëmuri që e dorëzon çështjen e tij para mjekut.

Gjithmonë Iben Abbasi r.a. i ka ndihmuar Zejd Ibën Thabitit që të hypë në deven e tij, dhe thoshte se kështu jemi të urdhëruar të veprojmë me dijetarët.

Në atë moment që nxënësi bëhet mendjemadh para mesuesit, dhe nuk dëshiron më të fitojë nga ai, atëherë bëhet injorant, sepse mençuria (hikmeti) është thesar i humbur i besimtarit, kudo që ta gjejë atë duhet ta marrë, dhe le ta lënë mendimin e vet (nxënësi) bashkë me mendimin e mesuesit të tij,

sepse disa raste mendimi i mesuesit të tij është më i qëlluar, edhe pse nxënësi mendon se ka gabuar.

Hazreti Aliu r.a. thotë: "Prej të drejtave që ka mesuesi yt prej teje, është se pas përshendetjes së përgjithshme, të bëhet përshendetja e veçantë me të, dhe të ulesh përballë tij. Mos ta përshendetësh dikë tjetër me dorë, apo mos t'ia bësh me sy dikujt tjetër. Mos të besh pyetje të teperta. Mos i ndihmo atij gjatë përgjegjes. Kur mesuesi (hoxha) dëshiron të pushojë pak nga ligjerata, ibadeti, mos nderhyjë ti duke i thënë: çka po tregon tjetër, çka po shpjegon. Kur ndërpritet nga përgjegjeja mesuesi, nuk bën ta detyrosh që të përseritet edhe një herë. Kur dëshiron të shkojë hoxha (mesuesi), s'duhet ta tërheqësh për rroba, dhe t'i thuash rri edhe pak. Fshehtësitë e tij mos ia perhap. Para tij mos bë gibet (përgojim). Mos bë përpjekje për ta zënë ngusht mesuesin. Nëse rastësisht ka gabuar diku, pranoja arsyen e gabimit. Mos thuaj para tij se mesuesi tjetër po thotë mendim tjetër, shoqërimi i gjatë me mesuesin të mos bëhet monoton dhe të largohesh prej tij. Mos u bë mendjemadh nga shërbimi ndaj hoxhës. Në rast se ekziston nevoja për ndihmë, mundohu të jesh para të gjithëve, se shembulli i dijetarit është sikurse trupi i hurmes së pjekur dhe pret prej saj se çka të bjen ndonjë kokërr dhe në hudhemi që ta kapim sa më shpejtë".

Dhe duhet të ketë kujdes nxënësi që mos t'i kushtojë rëndësi mospajtimit me të tjerët, se kjo ia huton mendjen dhe duhet që t'i kushtojë rëndësi diturive me kryesore, sepse jeta nuk mjafton për të gjitha dituritë.

Enes Koshi

Kl IVb

LËVIZJET SHKATËRRUESE NË HSITORINË ISLAME

(Vijon nga numri i kaluar)

Kazim Rishti vdes me 1849. Një vit pas Mirza ali Muhammedi shpallet se është Mehdiu i pritur. Pasuesit e tij e quajnë "Bab" (derë, portë) dhe lëvizja e tyre quhet Babije.

Rishti ka ushtruar ndikim edhe në një grua e cila më vonë në këtë lëvizje do të ketë rol dominues. Ajo quhej Zirin Taxh - Flokëarta. Emri i saj i vërtetë ishte Fatime dhe kishte lindur në Kazrin (Iran). Kur Mirza Ali Muhammedi shpallet "Mehdi", Zirin Taxh është përkrahseja e tij e parë. Ajo thoshte se gruaja është si lulja: "Lulja dashurohet, këputet dhe iu dhurohet miqve". Pas këtyre fjalëve shumë Babij e lëshuan lëvizjen. Ajo gjithashtu thoshte: "Njerëz, mendimet e shariatit islam janë hequr (shlyer). Sheriat tjetër nuk kemi; pra, jetojmë në kohën kur nuk ekzistojnë kurrfarë obligimesh e ndalimesh".

Shihet se kjo lëvizje kishte qëllim kryesor prishjen e familjes islame e cila ishte caku kryesor i kolonialistëve. E tërë Lëvizja babije ishte koncentruar në prishjen e normave të moralit të lartë islam.

Thonë se Mirza Ali Muhammedi u shpall si "Mehdi" në vitin 1850 në moshën 25 vjeçare. Ai tha se ka parë ëndërr kokën e Husejnit - birit të Aliut dhe vazhdon: "Kur jam zgjuar kam ndier se shpirti i Zotit është në mua dhe e ka mbizotëruar shpirtin tim".

Mirza ali Muhammedi prej Irakut shkon në Iran. Atje akuzohet për ngatërrimtar dhe ofendues i muslimanëve dhe Islamit. Një ditë në qytetin Shirazad, pas një ligjërate në xhami, ai tërhiqet nga mësimet e tij dhe kërkon falje. Por ai shpeshherë e ndryshonte mendimin e vet dhe me kërkesën e bashkëmenduesve të tij prapë kthehet në krye të Babijeve. Kjo dhe disa ngjarje tjera të jetës së tij, argumentojnë personalitetin e tij jostabil.

Me ndikimin e Zirin Taxh - Flokartes ai kërkon reformë në të drejtën familjare. Sipas tij femra duhet të martohet në moshën 11 vjeçare. Nëse burri nuk është në pajtim me gruan mund të shkurorëzohet 19 herë.

Nga kjo shihet çartë se Mirza Ali Muhammedi dëshiron shkatërrimin e familjes, ndërsa obligimi i vajzave në martesë, praqet Mirza Ali Muhammedin si njeri mentalisht të sëmurë. Ai numrin 19 e konsideronte të shenjtë. Viti te ai i kishte 19 muaj ndërsa muaji i kishte 19 ditë.

Mirza Ali Muhammedi filloi të shkruajë në gjuhën arabe. Shumicën e ajeteve kur'anore i ka lexuar më shumë gabime gramatikore sa që do t'i hetonte edhe ai i cili nuk i njeh mirë gjuhën arabe. Ai thoshte se ajo ishte shpallje që i dërgonte Zoti dhe se Ai ia shpallte në gjuhën arabe. Kishte për qëllim të argumentojë se shpallja e tij dhe Kur'ani kanë të njëjtin burim. Por nuk mund të quhet shpallje përmbledhja e tij me fjalë të pakuptueshme!

Kjo lëvizje u pa në sy të mirë nga perëndimi. Ata babijtë i quanin revolucionar e prijësat e tyre heronj. Orientalisti Goldziher për Mirza ali Muhammedin ka shkruar si për ndonjë hero, e mjaft vend te ai ka zënë edhe Zirin Taxh!

Rusia carsite ka shkuar aq larg sa që babijtë i ka ndihmuar edhe me para e armë. Qeveria ruse dërgoi njeriun me emrin Isa i cili u ndihmonte Babijve. Me vonë e dërgojnë edhe Menxher Hanin. Në kohën kur Babijtë kishin përgatitur atentat në shahin e Iranit, Mirza Ali Muhammedi u strehua më se 4 muaj në shtëpinë e Menaxher Hanit. Por edhe aty u zbulua. Atëherë Rusia intervenoi nëpërmes konsulates por pa sukses. Muhammed Babi u dënue me vdekje.

Shohim se sa herë formohen grupe - lëvizje në shtetet islame siç janë Kadijanijetë, Babijtë etj., aty është edhe faktori i jashtëm i cili për t'i realizuar qëllimet e veta u ndihmonte atyre lëvizjeve.

Behajetë

Tham se Rusia nuk arriti ta shpëtojë Muhammed Babin. Në mesin e atentatërëve në shahin e Iranit ishte edhe Mirza Husejni. Këtë të fundit Rusia arriti ta shpëtojë. Në vend të dënimit me vdekje Mirza Huseini dëbohet nga Irani për në Irak (Bagdad). Pra, lëvizja babije kalon në Irak.

(Vijon)

V l e r a e P u n ë s

Me punë dhe me hyrje në shoqëri njeriu, si qeni moralo-sociale, merr mbi vete shumë detyra dhe obligime. Kryerja dhe përmbushja e këtyre detyrave varet prej vetë jetës së tij, fatit dhe lumturisë në jetë. Prej asaj varet zhvillimi normal i familjes, bashkësisë së tij dhe mbarë njerëzimit. Çdo person ka obligime ndaj Allahut xh.sh. ndaj vetes, ndaj familjes, ndaj bashkësisë, ndaj pushtetit, ndaj njerëzve dhe ndaj të gjitha krijesave, njeriu mendjeshëndoshë dhe me ndërgjegje të paprishur e ka për detyrë të besojë në Allahun xh.sh. dhe t'i kryejë rregullat e fesë islame.

Obligimet e njeriut ndaj vetvetiut janë ta ruajë trupin dhe jetën e vet, mendjen dhe vlerën, për t'u edukuar në frymë të moralit të lartë.

- Feja islame prej nesh kërkon jetë të virtytshme e të urtë. Për atë edhe na i ka ndaluar pijet alkoolike, bixhozin, prostitucionin dhe veprat e tjera të këqia, sepse këto e shkatërrojnë jetën dhe errësojnë mendjen. Njeriu ka për detyrë t'i respektojë prindërit e vet, të kujdeset për edukimin e familjes së vet dhe mbajtjen e tyre. Prej muslimanëve kërkohet të jenë besnikë ndaj pushtetit. Ja si po shohim, puna po na lajmërohet si nevojë e domosdoshme jetësore me një vlerë të madhe të njeriut. Puna është fryt jo vetëm për njeriun, por edhe për të gjitha qeniet e gjalla. Mjafton të studiohet vetëm jeta e bubrecit dhe bletës, punën e tyre organizimin e tyre e të tjera. Po edhe gjithësia është në lëvizje, gjithnjë dhe praktikisht themi se është në punë e sipër. Kemi plot të drejtë të themi se puna është një ligj univerzal. Puna është iniciatore e jetës, burim i mirëqenies, bazë e civilizimit dhe faktor i njohur edukues. Të gjitha këto që njerëzit i kanë krijuar nëpërmjet të historisë prej gjilperës dhe perit, ndërtime të çuditshme në shekujt e mëparshëm, piramide të ndryshme dhe gjithçka deri në qytete vigane dhe të arriturat teknike dhe industria janë fryt të punës së palodhshme të njeriut, fuqi krijuese dhe kujdes. Edhe fitorja e kulturës shpirtërore dhe materiale prej sistemit filozofiko - juridik e deri te shpikjet e teknikës së hatashme, janë rezultat të njerëzve dhe punës së tyre. Me punë dhe me kujdes njeriu bëhet gjeni. Ç'vlera ka talenti pa punë Tedison thotë: "gjenia është 2% furnizimit 98% djesë", Prandaj puna nuk është vetë nevojë trupore, por aq më shumë është edhe nevojë psiko-shpirtërore. Puna nuk është ngarkim as mallkim e as që është ofendim ose poshtërim. Ajo duhet të jetë kënaqësi, duhet të jetë tërheqëse dhe nevojë, sepse ajo, shërben për

qëllimet e shumë njerëzve. Kur është fjala për punë, si nevojë psikike, më të cilën njeriu krijon shumë detyra jetësore, paraqitet problemi për vleftën e punës.

Muhamedi a.s. ka thënë: "Allahu e do atë musliman që merret me ndonjë zeje. Halifi i dytë H. Ymeri në kohën e të cilit më së shumti janë zgjeruar kufijtë e shtetit islam, gjithmonë i porositi mulimanët për tregti dhe zejтари. Në një rast shohim se thoshte: "Tregtia është e treta e të ardhurave të shtetit" prandaj muslimani e ka për detyrë t'i mobilizojë mundësitë e veta për zhvillimin e tregtisë dhe për mësimin e lloj-lloj zejeve të ndryshme. Muhamedi a.s. shumë herë falenderonte zejtarët duke iu thënë: "Tregtari i ndershëm (i drejtë) në ditën e gjykimit do të shoqërohet me profetët, më të devotshmit dhe me shehidët-dëshmorët. Shoku i profetit Enesi tregon se Muhamedi a.s. thotë "Tregtari i ndershëm (i drejtë) është nën hijen e Arshi Rrahmanit. Në një hadith tjetër ka thënë: "Tregtari i drejtë krahasohet me një melek të njohur ose të Allahut e ka vleftën e një meleku. mirëpo, nuk është mjaft vetëm me punë, po duke punuar duhet pasur kujdes për moralin e punës, sepse ligjet e fesë islame si dhe morali njerëzor kërkojnë që në marrëdhëniet e veta vetë njerëzit të kenë nderime, sinqeritet në qëllime dhe me fjalë pa gabime. Nëse këto marrëdhënie të njerëzve në punë nuk manifestohen atëherë nuk mund të folet për moralin e punës. Sipas këtyre haditheve, shpëtimi i një tregtari në të dy botërat varet prej besnikërisë dhe sinqeritetit në punë. Besnikërinë dhe sinqeritetin gjithkush e çmon edhe këtë prej njerëzve e kërkon vetë Allahu xh.sh. Në lidhje me nderin dhe sinqeritetin po e paraqesim edhe këtë rast, d.m.th. Rifaa ibni Rati tregon se njëherë ka dalë me Muhamedin a.s. në musala, ku Muhamedi a.s. i pa njerëzit kah po bëjnë tregti. Atëherë Muhamedi a.s. iu drejtua me zë të lartë. - O tregtarë të tubuar. Kur e dëgjuan tregtarët u kthyen kah Ai. Atëherë tha se tregtarët në jetën e ardhme do të dalin krahas me kriminelë dhe me mekate, përpos atyre të cilët drojnë për Zotin, punojnë me nder dhe sinqeritet, me këtë prandaj, profeti i Zotit deshi t'ua tërheq vërejtjen njerëzve për punë morale dhe të ndershme, të cilin islami e kërkon prej pasardhësve të vet. Një numër i madh tregtarësh në punë shpesh betohen për zotin ose në ndonjë tjetër duke pasur dëshirë që sendet e veta për shitje t'i shesë më shpejtë e më shtrenjtë, njerëzit e tillë harrojnë fjalet e Allahut xh.sh. dhe thëniet e Muhamedit a.s.

Lamtumirë Medrese

- Para katër vjetve ia mësymë Prishtinës, gjegjësisht Medresesë për t'u armatosur me dituri. Në mesin e shokëve dhe moshatarëve tonë dëgjohej se ne do të bëhemi hoxhë. Medreseja na dukej paksa misterioze, si diç jo e zakonshme, si diçka që duhet ta ndërrojë personalitetin tonë.

Në popull mbretëron bindja se ne nxënësit e Medresesë duhet të dallohemi nga të tjerët në veshmbathje, lojë etj. Dëshirojnë të na rrisin para kohe... Të gjitha këto paksa na frikësonin, por edhe kureshtja na nxiste, a thua si është Medreseja? Në kontaktin e parë me nxënësit e Medresesë fituam përshtypjen se kemi ardhur në mesin e moshatarëve tonë, ashtu si edhe të rinjtë tjerë ishin të hareshëm, luanin, kishin veshmbathje normale, por vërejtëm një dallim i cili në shiqim të parë duket i vogël, por shumë i rëndësishëm në jetën e mëtejme në Medrese.

Dallimi i parë ishte zgjimi herët në mengjes dhe përgatitja për namaz, përshtetja islame në mes shokëve, nga profesorët dhe përsonelet tjetër të Medresës. Askush nuk na e ndaloi lojen e aktivitetet tjera, por gjithnjë duke respektuar rendin shtëpiak.

Kaluan shpejtë katër vjet të cilat në fillim na dukeshin shumë të gjata. Mësuam dhe u edukuam në frymën islame, formuam botëkuptimin real, dhe u liruam nga iluzionet e çoroditura të rinisë bashkëkohore. U neveritëm nga alkooli, droga, prostitucioni e të këqijat tjera që i kanë kapluar rinin bashkëkohore.

Në jetën kolektive në konvikt u lodhëm emotivisht me njëri tjetrin. Vëllau prej babait dhe nënës më duket i barabartë me vëllau që e kam në Medrese. Erdhi koha të ndahemi ashtu si u ndamë nga prindërit, vëllezërit e motrat kur erdhëm në Medrese. Mallëngjehemi, por jemi të mbushur plot me elan shpirtëror që të nesërmen secili prej nesh, si një trup i vetëm të kryejë detyrën e vetë njerëzore. Jemi optimistë për jetën që kemi përpara sepse me diturinë dhe edukatën që

morëm në Medrese do të kontribuojmë në mirëqenien e atdheut dhe bashkësisë njerëzore.

Po ndahemi fizikisht njëri nga tjetri, por shpirtërisht jemi të lidhur përgjithmonë. Kudo që të shkojmë, kudo që të jemi nuk e harrojmë shtëpinë tonë, Medresenë, vëllezërit tonë dhe prindërit e dytë për të cilët lusim Allahun që t'i shpërblejë me të mirat e Tij.

Këtë vit shkollor 1995/96, në këtë vatrë edukativo-arsimore duhet të diplomojë gjenerata e XXX me radhë:

1. Adnan Pallaça	Rahovec	Rahovec
2. Adnan Simnica	Bellaqevc i M.	F. Kosovë
3. Ahmet Hoxha	Cërmjan	Gjakovë
4. Artan Musa	Brainë	Podujevë
5. Armend Kalanderi	Prizren	Prizren
6. Amir Isaku	Prizren	Prizren
7. Basri Shasivari	Brodosanë	Dragash
8. Bashkim Avdiu	Prishtinë	Prishtinë
9. Bekim Shala	Pejë	Pejë
10. Besim Limani	Gjilan	Gjilan
11. Behar Avdiu	Prishtinë	Prishtinë
12. Blerim Kamberi	Metohi	Podujevë
13. Blerim Krasniqi	Kamenicë	Kamenicë
14. Blerim Gashi	Hajvali	Prishtinë
15. Bujar Misini	Kabash	Viti
16. Burhan Hoxha	Pejë	Pejë
17. Dashnim Shkreli	Pejë	Pejë
18. Driton Iseni	Lluqan	Bujanovc
19. Driton Çengaj	Dragash	Dragash
20. Ejup Gashi	Prishtinë	Prishtinë
21. Ekrem Selimi	Buzovik	Viti
22. Emin Durguti	Rahovec	Rahovec
23. Enes Goga	Pejë	Pejë
24. Enes Koshi	Gjakovë	Gjakovë
25. Eroll Rexhepi	Pejë	Pejë
26. Fatmir Osmani	Mihaliq	Vushtrri
27. Faton Musa	Vushtrri	Vushtrri
28. Fatos Shala	Junik	Junik

Drita e Kur'anit

29. Fahrudin Bunjaku	Poliçkë	Kamenicë	46. Mirsad Kapllani	Reti e ultë	Prizren
30. Faulin Karhasku	Gjakovë	Gjakovë	47. Muhamed Dërmaku	Shipashnicë	Kamenicë
31. Fitim Gashi	Majac	Podujevë	48. Muhamed Krasniqi	Majac	Podujevë
32. Ibrahim Beqiri	Ferizaj	Ferizaj	49. Muhamed Xhemaili	Dobrosin	Bujanovc
33. Ibrahim Ramabaja	Sllakovc	Gjilan	50. Rasim Bytyqi	Deqan	Deqan
24. Ilir Ahmeti	Pejë	Pejë	51. Ramadan Hajdini	Brainë	Podujevë
35. Irfan Islami	Hajvali	Prishtinë	52. Rexhep Metolli	Hajvali	Prishtinë
36. Isa Alohaj	Kravar	Ulqin	53. Ruzhdi Imeraj	Istog	Istog
37. Islam Havolli	Llapashticë	Podujevë	54. Salih Beqiri	Slatinë e ep.	Viti
38. Ismet Hajdini	Vushtrri	Vushtrri	55. Safet Skenderi	Brrut	Dragash
39. Izet Gashi	Mramor	Prishtinë	57. Shemsi Jashari	Geraj	Preshevë
40. Jahja Lataj	Pejë	Pejë	58. Tefik Beqaj	Petrovë	Shtime
41. Jakup Çunaku	Barilevë	Prishtinë	59. Xhevat Ibrahim	Prishtinë	Prishtinë
42. Jeton Jupolli	Shajkovc	Podujevë	60. Zybejr Hyseni	Vushtrri	Vushtrri
43. Kushtrim Kelmendi	Pejë	Pejë			
44. Lutfi Veliu	Bradash	Podujevë			
45. Mehmet Sahiti	Preshevë	Preshevë			

E lusim Allahun xh.sh. që të na ndihmojë të takohemi, kështu si jemi pas dhjetë viteve, në vitin 2006.



Edhe një kujtim nga Medreseja - Gjenerata e XXX.

Letrat e lexuesve

- Të dashur lexues! Edhe kësaj radhe në redaksinë tonë kanë arritur një numër i konsiderueshëm i letrave tuaja përshëndetëse. Nëpërmes tyre ju shprehni gatishmëri bashkëpunimi me ne.

Nga numri i madh i përshëndetjeve veçuam:

Valdet Jusufi nga Drenovci KK Prishtinë, Mirsad Berisha KK Klinë dhe Ahmet Imeri nga Ferizaji, duke na përshëndetur përzemërsisht na urojnë punë të mbarë

dhe suksese të mëtejme. Ata njëherit nëpërmes tyre shprehin interesimin e madh ndaj fesë islame.

Të gjithë i falenderojmë për letrat dhe përshëndetjet e tyre duke dëshiruar që bashkëpunimi të vazhdojë edhe më tej. Gjithashtu u dëshirojmë suksese në mësim dhe lumturi të gjithmbarshme në jetë, duke iu përshëndetur me fjalët e Zotit xh.sh. *Es-Selamu alejkum.*

Redaksia

Në pvesim ju përgjigjuni

- Lexues të dashur, edhe kësaj radhe rubrika jonë ka zgjuar interesimin tuaj për njohuri të reja mbi islamin. Si dhe herave tjera, gjithashtu edhe kësaj radhe në redaksinë tonë ka ardhur një numër i letrave me përgjegje të sakta. duke e ditur se loja jonë shpërblyese ka edhe fituesit e saj, në këtë numër veçuam këta persona të cilët në pyetjet e parashtruara dhanë përgjigje korrekte:

Lulzim Gorani nga Peja, Femzi Simnica KK Prishtinë dhe Mirsad Behluli KK Bujanovc. Të gjithë atyre që nuk patën fatin kësaj radhe, u urojmë pjesëmarrje të suksesshme në të ardhmen.

Përgjegjet e pyetjeve nga numri i kaluar janë:

1. Pejgamberi a.s. hixhretin e bëri në vitin 622 m.

2. Agjërimi është bërë obligim në vitin e dytë të hixhretit.

3. Kur'ani filloi të zbrësë në muajin Ramazan.

4. Xhamia e parë që është ndërtuar në kohën e Muhamedit a.s. është Mesxhidi Kuba.

Ndërsa pyetjet e reja për këtë numër janë:

1. Në cilin muaj hënor kryhet obligimi i shenjtë - Haxhi?

2. Cilat janë farzet e Haxhit?

3. Në cilin vit sipas hixhretit Muhammedi a.s. e bëri haxhin e fundit?

4. Kur ndodhi lufta e madhe e Bedrit?

Mbesim me shpresë se nuk do ta keni vështirë të përgjigjeni.

Redaksia.

Fjalë kryqi

Horizontalisht - Vertikalisht

1. Libër i shenjtë, 2. Element kimi - Kalium, 3. Emër - lidhëz nënrenditëse vendore, 4. Shprehje e pranimit - lidhëz nënrenditëse kohore, 5. Nikëli - ai i cili e mëson Kur'anin përmendësh, 6. Nyje - sheriati islam mbështetet në... 7. Libër i shpallur prej Zotit.

Përgatiti: Adem Breznica IIIa

	1	2	3	4	5	6	7
1	K	U	R	A	N	I	
2	U	R	A	N	I		K
3	K	A				Z	U
4	A	N				O	K
5	N	I				T	A
6	I		Z	O	T	I	H
7		K	U	R	A	N	I